Shkolla mban evidencë për rregullshmërin e nxënësve në ditar dhe ditarin elektronik.

Mungesat e arsyeshme janë si rezultat i paraqitjes së gripit gjatë muajve të dimrit. Mungesat e paarsyeshme- janë një numër i vogël i nxënësve që vonohen në fllim të vitit shkollor, numër i nxënësve që mungojnë gjatë procesit mësimor.

Dy vitet e fundit ka qenë si shkak edhe gripi COVID 19, si dhe një numër i nxënësve të cilët për arsye sociale nuk kanë mundur të sigurojnë pajisje për ndjekien e rregullt të mësimit me çka shkolla ka aritur disa nxënës me gjendje sociale të dobët ti furnizoj me paisje elektronike(tablet) donacion nga një shoqat bamirëse nga fshati Pirok që vepron në Zvicër.(10 tableta)

Shkolla jonë gjithmon zbaton procedurat e shqiptimit të masave pedagogjike me dokumentacion bazuar në ligjin për arsim fillor, mirëpo nuk ka rregullore interne për mënyrën e shqiptimit të masave pedagogjike dhe deri tani nuk ka parashtruar fletëparaqitje për prindit dhe nxënësit që nuk e përcjellin rregullisht mësimin.

Shkolla ka evidencë për nxënësit e shpërngulur, mirëpo nuk i analizon më gjerësisht shkaqet, arsyet e shpërndarjes dhe të bëhet përpjekje të mundshme për zvogëlim të numrit. Bashkëpunon me qeverisjen lokale të ndërmerren aktivitete në kohë për zvogëlimin e numrit të shpërnguljeve.

Në bazë të evidencës në vitin shkollor, 2018 – 2019 nxënës të shpërngulur janë 7, në vitin shkollor 2019-2020 janë 9 nxënës dhe në vitin shkollor 2020-2021 të shpërngulur janë 13 nxënës.

Shumica e prindërve dorëzojnë në shkollë dokumenatacionin e nevojshëm, fletëregjistrim, vërtetim për vijim në shkollë tjetër, ndërsa ka disa raste të pakta të cilët nuk dorëzojnë dhe paraqiten të panotuar (me deklarata)..
Nxënës të ardhur gjatë viteve shkollore 2018-2019 ,2019-2020 si dhe 2020-2021 nuk kemi nxënës të ardhur.
Kjo procedurë në shkollë respektohet tërësisht. Procedurën e kalimit të nxënësit prej një shkolle në tjetrën.

AKTIVITETET NË TË ARDHMEN:

Në shkollë duhet të hartohet rregullore e brendshme në bazë të statutit shkollor.

Të bëhet përpjekje për motivim dhe nxitjen e nxënësve për gara si dhe shpërblimin e të njejtëve. Shkolla duhet të bëjë përpjekie edhe pse është e nevojës dhe sfidë e kohës për hapjen dhe funksionimit e web faqes së shkollës në interes të prestigjit dhe imazhit shkollor.

Fusha 3: Mësimi dhe mësimdhënia

Trequesit e cilësisë:

3.1. Planifikimet e mësimdhënësave
3.2. Procesi mësimor
3.3. Përvoja e nxënësve nga mësimi
3.4. Kënaqja e nevojave të nxënësve
3.5. Notimi si pjesë e mësimit
3.6. Informimi përparimin e nxënësve

Vetëevaluimi i shkollës:SH. F.K. „ Sami Frashëri " – Pirok – Bogovinë

Fusha 3: Mësimi dhe mësimdhënia

Mbledhja e të dhënave (cilat të dhëna janë mbledhur? Cilat metoda janë shfrytëzuar ?	
Shënoni të gjitha dokumentet e shqyrtuara	**Cilat informata janë mbledhur ?**
- *Planifikimet ditore, vjetore, tematike* - *Procedura interne e përcaktuar për ndjekien dhe planifikimit të mësimdhënësve* - *Biseda me drejtor,* - *Evidenca shkollore,* - *Anketa me arsimtarë,* - *Anketa me nxënës*	***Treques i cilësis: 3.1 Planifikimi i mësimdhënësëve*** ***Tema:3.1.1 Mbështetja dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënasve*** Shumica e arsimtarëve kanë të përgatitur planifikimin vjetor tematik – (disa në nivel të aktiveve), plan operativ i orës mësimore ku te një numër i madh i arsimtarëve përmban të gjitha elementet për realizim të sukseshëm të procesit mësimor. Qëllimet e orës mësimore të pritura nga efekti i mësimit dhe mënyrës së notimit janë qartë të vërtetuara në planifikimet e pjesës më të madhe të mësimdhënësve,planifikimet përcillen nga shërbimi pedagogjik në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit shkollor.
- *Evidenca e pedagogut* - *(planifikimet vjetore,tematike-ditore)* - *Procedura interne e përcaktuar për ndjekien dhe planifikimit të mësimdhënësve* - *Anketa me drejtorin e shkollës* - *Anketa me arsimtarë,* - *Anketa me nxënës*	***Tema:3.1.2 Planifikimet individuale të mësimdhënsëve*** Shkolla ka qasje dhe kontrollon planifikimet, përcjelljen e të cilave e bënë drejtori, pedagogu i shkollës – përmes vizitave nëpër orë mësimore, mbështetje profesionale, udhëzime, këshillime përmes këshillimeve individuale apo nivel të aktiveve profesionale, me çka arsimtarët – pjesa më e madhe për çdo temë mësimore pregadisin dhe dorëzojnë plan procesual te shërbimi pedagogjik. Para fillimit të vitit shkollor arsimtarët përgatitin planifikime globale,tematike në mësimin obligativ,A,L,N,mësim shtues-plotësues si në formë elektronike dhe të shtypura në letër të cilat dorëzohen te pedagogu i shkollës ku ka qasje të plotë.Ndërsa planet tematike- profesionale në fillim të cdo teme. Planifikojnë edhe planikime ditore të cilat i përmbajnë të gjitha komponetet për realizimin më efikas dhe më të suksesshëm të orës mësimore (Qëllimet, metodat, format, notimin,TIK-un, teknikat,etj. Puna e nxënësëve përcjelet përmes vizitave nëpër orë mësimore. Përkrahje gjatë përcjelljes së planifikimeve., organizimin dhe realizim të seminareve nga BZHA interne.si shoqatat e akredituara .

- - *Proçese të aktiveve profesionale* *Bisedat me drejtorin*	***Tema:3.1.3 Shkëmbimi i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit*** Diskutohet në nivel mbledhjeve, analizave të përmbatjeve programore mirëpo përvojat, idet, nevojitet të këshillohen gjatë konsultimeve individuale – sidomos lëndët e përafërta apo nivel të paraleleve. Ku ka ndryshime ,risi etj.,ka raste të ralla ku planifikojnë në kuadër të timeve profesionale sidomos tik-un,integrim të përmbatjeve programore në korrelacion të lëndëve mësimore, por vetëm në kuadër të timeve profesionale.
- *Orari i mësimit* - *Plani – orari i mësimit shtues – plotësues* - *Programi i shkollës* - *Ditarët* - *Bisedat me drejtorin*	***Tema:3.1.4 Orari i mësimit*** Orarin e mësimit shkolla e ka funksional dhe në kohë, pregaditet nga drejtori dhe persona te caktuar përgjegjës në bazë të orareve të mësimit, lëndeve, fondin e orëve, ndërimeve, dhe orar për planifikimin dhe realizimin e orëve shtuese – plotësuese, të cilat gjithmon janë në vend publike apo të shpaljes për informim të nxënësve dhe prindërve. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe,ndërsa arsimtarët në mësim klasor përgatitin orarin në bazë të planit mësimor bazuar me kushtet gjatë ditëve të punës.
- - - *Planet ditore* - *Evidenca e orëve të vëzhguara* - *Bisedat me drejtorin* - *Procedura interne e përcaktuar për ndjekien dhe planifikimit të mësimdhënësve* -	***Tequesi i cilësis: 3.2 Procesi mësimor*** ***Tema:3.2.1 Format dhe metodat mësimore*** Gjatë realizimit të mësimit një numër i madhë i arsimtarëve shfrytëzojnë forma dhe metoda mësimore të cilat mundësojnë aktivitete dhe interakcion më të madhë, format e punës në grupe realizohen nga një pjesë e mësimdhënëseve, mësim individual dhe në grupe, metoda e bisedës, sqarimit, monolog dhe dialog, prezantimet, me çka nuk përfshihen llojet e stileve te mësuarit për mundësi të zhvillimit individual të çdo nxënësi. Për realizimin e sukseshëm të përmbatjeve programore shfrytëzohen resurset e mundshme, llaptop, kompjuter, projektora, smart-tabela, mjete mësimore të pregaditura nga nxënësit. Numër i madh i nxënësve janë aktiv për zgjedhje të problemeve të ndryshme mësimore, qëndrime, diskutime, projekte ku vërehet dhe në të shumtën e rasteve vërehet mundësi e mirë për zhvillim të të menduarit kritik për mësim. Një numër i mësimdhënësve kanë realizuar një numër të madh të njësive mësimore elektronike duke e pasuruar platformën EDUINO me një numër të madh të njësive mësimore.

- *Planet ditore* - *Intervista me arsimtar dhe nxënës* - *Proçesverbalet e ISHA,* - *Evidenca e orëve të vëzhguara*	***Tema:3.2.2 Përdorimi i TIK-ut gjatë mësimit*** ***Shkolla disponon me numër të mirë të mjeteve mësimore ndihmëse : kompjutora, llaptopa,projektor, internet, me cka procesi mësimor realizohet në kontinuitet me cka u jepet mundësia me sukses të realizojnë shkathtësit individuale për mësim të cdo nxënësi si dhe shkathtësi për bashkëpunim dhe komunikim.*** - Gjatë realizimit të mësimit mundësi efektive është edhe qasja e rrjetit të nternetit si formë për realizimin e TIK-ut në mësim të përmbatjeve programore të planifikuara.. Gjatë vizitave në orë konstatohet se planet tërësisht realizohen, dhe gjatë vizitave të I.SH.A. me qëllim të TIK-ut në shkollë nuk ka procedura për vërejtje apo precesverbale me përmbatje jokualitative dhe pa plan,po përkundrazi realizohen qëlimet programore dhe kërkesat ligjore.Nëpër klasë nuk ka numër të mjaftueshëm të kompjuterave apo llaptopave për nevojat e nxënësve
- *Planet ditore* *Evidenca e orëve të vëzhguara* - *Proëesverbalet nga mbledhjet e grupeve profesionale*	***Tema:3.2.3 Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve*** Gjatë vizitave nëpër orë mësimore nga drejtori, pedagogu si dhe komisioni për vetëvlerësim vërtetohet se shumica e arsimtarët kanë planifikime ditore, punojnë në bazë të planifikimeve tematiko – procesuale, ka bashkëpunim, numër i vogël i mësimdhënësve zbatojnë teknika, aplikim të vlerësimit, punimet e nxënësve vetëm në disa klasë ishin të eksponuara, si dhe forma dhe mënyra e detyrave të shtëpisë planifikohen por vërehen lëshime gjatë plotësimit kërkesave nevojave si dhe bashkëpunimi i ulët për vëllimin e detyrave, kohëzgjatjen si dhe paraqitjen e disa rasteve për shfrytëzim të resurseve të mundshme ekonomike për arritjen e qëllimeve.Arsimtarët planifikojnë detyra dhe aktivitete të cilat duhet të realizohen në shkollë si dhe detyra shtëpie të cilat u përshtaten nevojave të nxënësëve me qëllim që të arrihen qëllimet e parapara në mësimdhe i kushtohet kujdes i veçant statusit social dhe familjar të nxënësve për resurset e mundshme për detyrat e dhëna..
-Intervista me arsimtarë, nxënës dhe prindër *-Rezultatet nga anketat dhe bisedat me drejtorin, arsimtarët dhe nxënësit*	***Tema3. 3.2.4 Marëdhëniet interaktive midis mësimdhënësve dhe nxënësve*** Pjesa më e madhe e mësimdhënësave informojnë nxënësit për qëllimet e mësimit. Mirëpo gjatë arritjes së rezultateve të mira rrallë herë i lavdërojnë si formë stimuli apo motivimi dhe vetëm në moment. Arsimtarët planifikojnë planet e tyre interakcioni, dhe e njëjta realizohet në mes mësimdhënësve – nxënëse si dhe raste të mësimit aktiv ka interakcion nxënës – nxënës gjatë aktiviteteve në mësim ,në tërësi raportet janë të mira.

- *Protokollet e orëve të vëzhguara* - *Fakte të tjera për korrespodencë*	***Tema:3.2.5 Qasja e mësimdhënësave ndaj nxënësve*** Shumica e mësimdhënësëve kanë qasje profesionale ndaj nxënësve, ndihmohet gjatë realizimit të mësimit të rregullt, aktiviteteve të ndryshme në shkollë, qasje të barabartë ndaj meshkujve dhe femrave (bazuar në gjini), .Arsimtarët aplikojnë qasje pozitive për nxitje dhe motivim te nxënësit që të marin pjesë aktive në procesin mësimor (lëvdata,biseda etj.) Sjellja është e ndësjelltë tek të gjithë subjektet.
- - *Programi për punën e shkollës* - *Mbledhjet me këshillin e arsimtarëve, statistikat*	***Tema:3.2.6 Ndjekja e procesit mësimor*** Në bazë të planifikimit shkolla ka procedura dhe mënyra për përcjelljen e procesit mësimor – gati se tërër vitin shkollor, analizë e përmbatjeve, rekomandime për përmisime dhe menjanimin e lëshimeve –eventuale – përcillet nga strukturat udhëheqëse të shkollës, bashkëpunëtor profesional ku shkolla nuk ka plan konkret për evaulim të aktiviteteve me plan të veçantë. Është e nevojshme dhe duhet të hartohet dhe të miratohet procedura për përcjelljen e procesit mësimor. Shkolla disponon me hapsira të nevojshem për realizimin e rregulltë, mirëpo ka vështërsi për realizim të sukseshëm të orëve të edukatës fizike gjat stinës së vjeshtës dhe dimrit pasi që kemi munges të sallës sportive.
- - *Programi për punën e shkollës* - *Raportet nga anketat*	***Trequesi i cilësis: 3.3 Përvojat e nxënësve nga mësimi*** ***Tema: 3.3.1. Mjedisi i mësimit*** Mjedisi i mësimit i përmbush kërkesat dhe nevojat e nxënësve(mësimi kabinetik, mjete mësimore, rekuizita sportive, mjetet ndihmëse mësimore.) Shumica e arsimtarëve – pjesa më e madhe në mësim klasor rregullisht në bazë të resurseve përgaditin kënde për punimet e nxënësve apo krijimet – të cilat me të vërtet paraqesin kontributin, arritjet, pamjen pedagogjike dhe estetike të klasave si dhe inkurajimin e arsimtarëve dhe nxënësve për punë. Në përthësithësi kënaqen realizimi i mësimit nëpër mësojtoreve të cilat janë tradicionale me mjete të pamjaftueshme ,higjiena është mirë ,viteve të fundit janë bërë ndryshime të mëdha në përmësimin e kushteve infrastrukturore.të cilat janë pjesë motivuese për interesimin e nxënësve në mësim.
- - *Anketa me nxënës* - *Bisedat*	***Tema:3.3.2 Atmosfera e mësimit*** Shkolla realizon përmbatjet e planifikuara, programin për punën e shkollës implementon konform planifikimit dhe detyrat, obligimet që dalin dhe kërkohen nga subjektet përgjegjëse. Në shkollë ka atmosferë pune, ka klimë pune mirëpo duhet të bëhet përpjekje për sigurim të disa kushteve që janë pjesë e procesit dhe të motivohen nxënësit dhe të punësuarit për arritjet e qëllimeve të pëbashkëta individuale apo të përgjithshme me interes të shkollës dhe bashkësisë vendore,shumica e arsimtarëve i inkurajojnë

	nxënësit për të menduar kritik dhe të shprehin mendimet e tyre..
- *Proçesverbal me bashkësin e nxënësve,* - *Anketa me arsimtarë dhe nxënës*	***<u>Tema:3.3.3 Nxitja e nxënësve për marjen e përgjegjësisë</u>*** ***Nxënësëve në përgjithësi u pëlqen mjedisi për mësim,e cila vërtetohet edhe nga numër i madhë i prindërve me cka konstatohet se klasat janë në gjendje të mirë dhe kanë motiv për mësim.Shkolla nuk hallë sportive për realizim efikas të lëndës së A.f.sh njëkohësisht për realizimin e aktiviteteve dhe manifestimeve shkollore.*** Shkolla mundohet të nxis, motivon nxënësit për përgjegjësit ndaj procesit mësimor, qëndrimin e drejtë ndaj pronës dhe vlerave shkollore përmes diskutimeve, rendit shtëpijak, kodeksi të sjelljes dhe obligimeve ndaj procesit mësimor. Gjatë mësimdhënie i kushtohet kujdes të mësuarit, detyrave dhe obligimeve, projekteve, aktiviteteve të ndryshme gjatë vitit shkollor, manifestimeve, realizimin e garave. Mirëpo shkolla duhet më tepër ti kushtojë kujdes qëllimeve edukative si përfshirjen më të madhe të nxënësve në jetë dhe punën e shkollës..
- *Evidenca e punës së drejtorit dhe pedagogut*	***<u>Tema:3.3.4. Marëdhëniet interaktive të nxënësve mes veti dhe me të rriturit</u>*** Ekziston bashkëpunim i mirë, sjellje, komunikim, respekt gjatë qëndrimit në shkollë, gjatë orëve mësimore nivel të paraleles. Raport më të rritur janë në nivel të duhur,baashkëpunimi, realizim të kërkesave dhe obligimeve në jetën dhe punën e shkollës. Në shkollë nuk ka raste të rënda të apo procedura tjera për keqësim të raporteve, marëdhënieve apo diçka tjetër.Vlen të theksohet në mësimdhënien interaktive shprehet më tepër.

- *Anketat* - *Proçesverbalet me prindë* - *Proçesverbal me këshilline shkollës* - *-rregullorete punës*	**Treguesi i cilësis: 3.4. Kënaqja e nevojave të nxënësve** **Tema:3.4.1. Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve** Kuadri arsimor dhe bashkëpunëtor profesional mundohen të njohin dhe identifikojnë mirë nevojat arsimore dhe pengesat në procesin mësimor të cdo nxënësi të cilat identifikohen sipas arritjes të rezultateve në fusha të ndryshme,sipas nevojave mund të përcjellin aktivitete dhe mundohen në menjanimin e të njëjtave .
- *Proçesverbal me këshillin e arsimtarëve* - *Evidenca e pedagogut*	**Tema:3.4.2. Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim** Shkolla zbaton procedurat për nevojat e nxënësve në mësim . Mirëpo nuk ka akte interne të brendshme, për nxënësit me nevoja të veçanta, nxënës me paraqitje emocionale. Në përgjithësi përmbushen kërkesat arsimore.Arsimtarët pregaditin detyra dhe aktivitete sipas nevojave të nxënësëve me çka motivohen,duhet më tepër angazhim për përmbushjen e kërkesave dhe qëllimeve të këtilla.bazuar në stilet e mësimit nga përvoja,shumica e mësimëdhësve shfrytëzojnë teknika të ndryshme interaktive për mësim dhe notim
- *Evidenca për trajnim* - *Çertifikatat e arsimtarëve*	**Treguesi i cilësis: 3.5 Notimi si pjesë e mësimit** **Tema:3.5.1. Politika e shkollës për notim** Shkolla zbaton normativat ligjore të cilat rregullojnë notimin e nxënësve, definuar në bazë të politikave të notimit (vlerësimit) – duhet përfshirë kodeksin e notimit, ku pjesa më e madhe e arsimtarëve janë të trajnuar për zbatimin e standarteve të notimit, në kuadër të komponentës përparimi i notimit në shkollë duke përfshirë metodat, format kriteret, faktorët etj. Ku të njëjtata nga shumica e arsimtarëve zbatohen mirëpo shkolla duhet ë hartojë rregullore për notimin intern të nxënësve në shkollë për implementimin më efikas të kodeksit të notimit si dhe të kontribohet në notim real dhe objektiv ku duhet të kontribohet më tepër në informimin e nxënësve dhe prindërve për kriteret e harmonizuara të notimit.
- *Ligji për arsim fillor* - *-orët e vizituara*	**Tema:3.5.2.. Metodat dhe format e notimit** Procedura e notimit në bazë të ligjit për arsim fillor klasat I – III notohen me notim përshkrues, klasat IV-VI me notim të kombinuar me shkrim dhe kl.VII-IX numerik duke u mbështetur në përcjelljen e të arrtiurave të nxënësve me metoda portfolio, teste, instrumente, me gojë, me shkrim, çek lista, lista evidentues, fleta analitike. Për çdo nxënës gjatë vitit shkollor –për përcjelljen e të arriturave si dhe

	formën e përfshirjes së nxënësve në vetëvlerësimn në bazë të metodave dhe formave për notim.Në shkollë pjesa më e madfhe zbatojnë(standardet dhe kriteret e notimit të dhëna nga B.ZH.A dhe M.A.SH.,me cka zbatohen aktet ligjore të cilat rregullojnë procedurën e notimit.Notimi është real,transparent dhe përcjellet me diskutime të cilat ndihmojnë nxënësëve në punën e tyre.
- *Instrumentet për vlerësim* - *Procesverbalet e mbledhjeve* - *Fletat evidentuese*	***Tema: 3.5.3..Shfrytëzimi i informatave dhe notimi në mësim*** Nxënësit në kontuinitet marin informata kthyese nga pjesa më e madhe e arsimtarëve për arritjet e tyre përmes instrumenteve për vlerësim, ku të njejtat vërtetohen nga prindërit. Duke zbatuar procedurat e notimit. Gjatë mësimit mundësohet detektim i plotësimit të lëshimeve të arsimtarëve si dhe përmbushja e nevojave të qëllimeve arsimore për nxënësit, nivelit të diturive duke u mundësuar të gjitha nivelet e njohjes sipas taksonomis së Blumit.(në veçanti klasat IV-IX) si dhe të mbeshtete kodeksin e notimit
- *Evidenca e mbledhjeve prindërore* *-Shënimet* *Evidenca për këshillime* - *Proçeset nga raporti i punës së shkollës*	***Trequesi i cilësis: 3.6.Informim për përparimin e nxënësve*** ***Tema: 3.6.1.Informimi i prindërve për përparimin e nxënësve*** Shkolla respekton procedurën dhe në kohë informohen prindit për përparimin e fëmijëve të tyre. Procedura përfshin grumbullim të dhënave, arsimtarët japin informata kthyese e të përgjithshme për suksesin – në tremujorin e parë, gjysmvjetorin , tremujorin e tretë me fleta evidentues ku nënskruhen nga prindët, mirëpo dukshëm vërehet numër i prindërve nuk shprehin interesim dhe bashkëpunim sidomos në organizimin e mbledhjeve prindore. . Shkolla gjithmon është e hapur të plotësojë nevojat dhe mënyrës më efikase për informim prindëror me qllim të për përparimin e fëmijëve të tyre. .

Vetevaluimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri “ – Pirok – Bogovinë

Fusha 3: Mësimi dhe mësimdhënia

Mbledhja e të dhënave (cilat metoda tjera janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave ?) (shembuj, pyetësor, anketime, vëzhgime...)		
Theksoni cilat metoda tjera janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	**Pjesëmarrja: Cili ka qenë i përfshirë në mbledhjen e këtyre informacioneve**	**Cilat informacione janë mbledhur?**
Anketë	***Ekipi i vetevaulimit***	**Shkolla fillore komunale “Sami Frashëri” f.Pirok** **ANKETË PËR ARSIMTARË : MËSIMI DHE MËSIMDHËNIA** **Nxënës të nderuar, para jush keni pyetje lidhur me mësimin dhe mësimdhënien që realizohet në shkollën tuaj, e të cilave duhet tu përgjigjeni në mënyrë sa më reale që mundeni. Vendos “√”, në katrorin që mendon se është e drejtë.** ***Anketë për arsimtarët*** Anketa është përpunuar në Forms dhe është shpërndarë përmes platformës Teams. Realizuar nga arsimtaret Luljeta Shabani dhe Memed Mehmedi. Janë përgjigjur gjithsejt 26 respondent, rezultatet e përgjigjeve janë dhënë më poshtë me diagram shtyllor.



Arsimtarë të nderuar, para jush keni pyetje lidhur me mësimin dhe mësimdhënien që realizoni në shkollën tuaj, e të cilave duhet tu përgjigjeni në mënyrë sa më reale që mundeni. Vendos "√", (kliko shtyp ose vegëzo) në katrorin që mendon se është e saktë.

Nr.		PO	SHUMË	DERI DIKU	JO	NUK E DIJ
1.	Në fillim të vitit shkollor, u shpjegoni në detaje nxënësve se çfarë do të mësohet gjatë vitit shkollor?	83%	8%	8%	0%	1%
2.	Planet dhe programet mësimore që i shfrytëzoni janë të përshtatshme?	77%	0%	23%	0%	0%
3.	Shfrytëzoni dy e më shumë forma të punës në mësimdhënie?	96%	0%	4%	0%	-0%
4.	Keni mjete mësimore të mjaftueshme për realizimin efektiv të programeve mësimore?	46%	15%	38%	0%	0%
5.	Ju jeni të kënaqur nga mësim- nxënia e nxënësve gjatë mësimdhënies?	50%	0%	50%	0%	0%
6.	Ju përdorni teknologjinë moderne në mësim?	54%	0%	46%	0%	0%
7.	Mësimdhënia është individuale, detyrat dhe aktivitete janë të përshtatshme për nevojat e secilit nxënës?	69%	0%	31%	0%	0%

			8.	Me kujdes i vlerësoni nxënësit me aftësi të ndryshme, duke marrë parasysh faktin se gjithkush motivohet nga një nxitje e përshtatshme?	100%	0%	0%	0%	0%
			9.	Gjatë notimit merret parasysh përparimi individual i çdo nxënësi?	100%	0%	0%	0%	0%
			10.	Mësuesit rregullisht informojnë nxënësit për arritjet dhe përparimet e tyre?	97%	0%	3%	0%	0%
			11.	Me nxënësit bisedoni rregullisht rreth të arriturave të tyre?	88%	0%	12%	0%	0%
			12.	Mësuesit përdorin vlerësimin për të përcaktuar efektivitetin e mësimit të tyre dhe të mësimdhënies?	88%	0%	12%	0%	0%
			13.	Prindërit janë të inkurajuar që të bashkëpunojnë me mësuesit për të monitoruar përparimin e nxënësit?	69%	0%	31%	0%	0%
			14	Rezultatet nga mbledhjet prindërore për të arriturat dhe notimin e nxënësve, a janë të respektuara?	77%	0%	23%	0%	0%

		Në pyetjet e hapura të cilat kanë qenë në fund të anketës në lidhje me bashkëpunimin dhe këmbimin e përvojave dhe ideve për planifikimet vjetore dhe tematike, ku pyetja ishte: "Çka mendoni për bashkëpunimin dhe këmbimin e përvojave dhe ideve për planifikimet vjetore dhe tematike?", mendimet kanë qenë të ndarë sepse një pjesë më e madhe e arsimtarëve deklarohen se kanë bashkëpunim dhe këmbim në nivel të duhur, kurse një pjesë tjetër që janë me numër më të vogël deklarohen se bashkëpunimi dhe këmbimi i përvojave është në nivel të ulët, respektivisht 17 prej tyre deklarohen se kanë bashkëpunim, 4 jo, 5 deklarohet se nuk e di, ndërsa pjesa tjetër e respondentëve nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje. Pyetja e fundit në pyetësor që ka qenë e dedikuar për sugjerimet e arsimtarëve dhe diçka të rëndësishme që nuk është thënë, arsimtarët kanë përmendur se motivimi i arsimtarëve të cilët përveç procesit edukativo – arsimor kanë qenë të angazhuar edhe me punë të tjera, ka qenë në nivel të ulët. Kishte edhe të tillë që përmendnin edhe mjetet mësimore të shtohen edhe më shumë në shkollë.

ANKETË PËR NXËNËS

MËSIMI DHE MËSIMDHËNIA

Anketa është përpunuar në Forms dhe është shpërndarë përmes platformës Teams.

Realizuar nga pedagogu i shkollës Memed Mehmedi dhe arsimtarja Ismije Rushiti.

Janë përgjigjur gjithsejt 53 respondent, rezultatet e përgjigjeve janë dhënë më poshtë me diagram shtyllor.



Nr		Po	Jo
1.	Mësuesit më nxisin që të mendoj dhe të krijoj ide të reja.	96%	4%
2.	Në shkollë kam mësuar shumë gjëra të dobishme.	100%	0%
3.	Mësuesit përsëri përpunojnë njësitë që nuk i kemi kuptuar.	92%	8%
4.	Mësuesit kontrollojnë rregullisht njohuritë e nxënësve.	92%	8%
5.	Notimi është i drejtë dhe mirë i punuar.	92%	8%
6.	Shumica e arsimtarëve janë rigoroz në notim.	34%	66%

		7.	Në shkollë nxënësit mësojnë kulturë si të komunikojnë me njerëzit tjerë.	96%	4%
		8.	A merret parasysh mendimi i juaj për zgjedhjen e lëndës zgjedhore?	82%	18%
		9.	Anotoheni dhe vlerësoheni gjatë gjithë vitit?	98%	2%

Çka mendoni për bashkëpunimin dhe këmbimin e përvojave dhe ideve për planifikimet vjetore dhe tematike?_____

_____

_____

_____.

Ju lutem shkruani në këtë fushë atë që mendoni se është e rëndësishme dhe ne nuk e pyetëm.
Çdo gjë që Ju shkruani mbetet plotësisht anonime.

Anketa	***Ekipi***	

Vetevaluimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri " – Pirok– Bogovinë

Fusha 3: Mësimi dhe mësimdhënia

Rezultatet: këtu duhet shkurtimisht të arsyetohen anët tona pozitive (të forta) dhe negative (të dobëta)
Anët e forta: ✓ ***Pjesa më e madhe e mësimdhënësve planifikojnë dhe realizojnë mësimin duke u mbështetur dhe respektuar kërkesat ligjore, qëllimet dhe integrimet arsimore*** ✓ ***Orari për realizim të mësimit gjithmonë ka qenë i përgatitur me kohë, gjegjësisht me fillimin e vitit shkollor,*** ✓ ***Në shkollë ka atmosferë pune si dhe ambient të këndshëm gjatë qëndrimit në punë,*** ✓ ***Pjesa më e madhe e kuadrit arsimor kanë planifikime dhe metoda për procedurën e notimit, vlerësimit të nxënësve,*** ✓ ***Ka planifikime dhe implementim të përmbajtjeve mësimore me TIK*** ✓ ***Gjatë realizimit të mësimit ekziston interaksion efikas në mes të subjekteve mësimdhënës-nxënës dhe nxënës-nxënës,*** ✓ ***Prindërit dhe nxënësit informohen me kohë për përparimin e fëmijëve të tyre si dhe nxënësit për përparimin individual,*** ✓ ***Shkolla informon të gjitha informatat nga notimi i nxënësve për analiza krahasuese, raporte, vetevaluime si dhe diskutohet në organet profesionale***
Anët e dobëta: ✓ ***Bashkëpunim jo i mjaftueshëm i një numri të prindërve në realizimin e mësimit dhe përmbajtjeve programore,*** ✓ ***Shkolla duhet të bëjë përpjekie dhe të hartojë rregullore për notimin intern të nxënësve,*** ✓ ***Një numër i mësimdhënësve nuk zbatojnë teknikat e mundshme për vlerësim (notim) objektiv,*** ✓ ***Shkolla duhet të bëjë përpjekie për procedurën e shpërblimit për nxënësit e talentuar, dhurata, si pjesë e nxitjes dhe ndikimit pozitiv ndaj vlerave shkollore,*** ✓ ***Duhet më tepër të bëhet përpjekie për planifikim dhe realizim të orëve të hapura- me qëllim të këmbimit të përvojave të ekipeve profesionale***
Analiza e rezultateve: Planifikimet vjetore, tematike dhe ditore kontrollohen dhe përcillen në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit shkollor nga shërbimi pedagogjik ku nga evidenca e mbajtur është konstatuar se shumica e arsimtarëve kanë të përgatitur planifikimin vjetor tematik – (disa në nivel të aktiveve), plan operativ i orës mësimore ku te numër i madh i arsimtarëve përmban të gjitha elementet për realizim të sukseshëm të procesit mësimor.

Qëllimet e orës mësimore të pritura nga efekti i mësimit dhe mënyrës së notimit janë qartë të vërtetuara në planifikimet e pjesës më të madhe të mësimdhënësve, planifikimet përcillen nga shërbimi pedagogjik.

Përcjelljen dhe kontrollimin nga ana e shkollës e bën drejtori, pedagogu i shkollës – përmes vizitave nëpër orë mësimore, mbështetje profesionale, udhëzime, këshillime përmes këshillimeve individuale apo në nivel të aktiveve profesionale, me çka arsimtarët – pjesa më e madhe për çdo temë mësimore përgaditin dhe dorëzojnë plan procesual te shërbimi pedagogjik. Para fillimit të vitit shkollor arsimtarët përgatitin planifikime globale, tematike në mësimin obligativ, A,L,N, mësim shtues-plotësues si në formë elektronike dhe të shtypura në letër të cilat dorëzohen te pedagogu i shkollës ku ka qasje të plotë, ndërsa planet tematike - profesionale dorëzohen në fillim të çdo teme. Arsimtarët planifikojnë edhe Plane Ditore të cilët i përmbajnë të gjitha komponetet për realizimin më efikas dhe më të suksesshëm të orës mësimore (Qëllimet, metodat, format, notimin,TIK-un, teknikat,etj.)
Puna e nxënësëve përcillet përmes vizitave nëpër orë mësimore. Arsimtarëve u jepet përkrahje nëpërmes organizimit dhe realizimit të seminareve nga BZHA, seminare interne si dhe nga shoqatat e akredituara.

Rrallë herë diskutohet në nivel të mbledhjeve. Analizat e përmbatjeve programore bëhen përmes këmbimit të ideve. Përvojat dhe idetë këmbehen gjithashtu gjatë konsultimeve individuale – sidomos në lëndët e përafërta apo në nivel të paraleleve. Ku ka ndryshime, risi etj. Ka raste të rralla ku planifikojnë në kuadër të grupeve profesionale sidomos TIK-u, integrim të përmbatjeve programore në korrelacion të lëndëve mësimore, por kjo bëhet vetëm në suaza të grupeve profesionale.

Orarin e mësimit shkolla e ka funksional dhe në kohë. Ai përgatitet nga drejtori dhe persona te caktuar përgjegjës në bazë të orareve të mësimit, lëndeve, fondin e orëve, ndërrimeve, dhe orar për planifikimin dhe realizimin e orëve shtuese – plotësuese, të cilat gjithmonë janë të ekspozuara në vend publik apo të shpalljeve për informim të nxënësve dhe prindërve. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa arsimtarët në mësim klasor përgatitin orarin në bazë të planit mësimor bazuar me kushtet gjatë ditëve të punës.

Shkolla disponon me numër të mirë, por jo të mjaftueshëm të mjeteve mësimore ndihmëse: kompjutora, llaptopa, ndërse tabela të mençura janë të vendosura në çdo klasë, projektor, internet, dhe procesi mësimor realizohet në vazhdimësi ku arsimtarëve u jepet mundësia me sukses të realizojnë shkathtësitë individuale për mësim të cdo nxënësi si dhe shkathtësi për bashkëpunim dhe komunikim. Gjatë realizimit të mësimit një numër i madh i arsimtarëve shfrytëzojnë këto mjete duke përdorë forma dhe metoda mësimore të cilat mundësojnë aktivitete dhe interakcion më të madh.
Gjatë realizimit të mësimit mundësi efektive është edhe qasja e rrjetit të internetit si formë për realizimin e TIK-ut në mësim të përmbatjeve programore të planifikuara. Gjatë vizitave në orë konstatohet se planet tërësisht realizohen, dhe gjatë vizitave të I.SH.A. me qëllim të TIK-ut në shkollë nuk ka procedura për vërejtje apo precesverbale me përmbatje jokualitative dhe pa plan, por përkundrazi realizohen qëllimet programore dhe kërkesat ligjore. Nëpër klasa nuk ka numër të mjaftueshëm të kompjuterave apo llaptopave për nevojat e nxënësve.

Mësimdhënësit i informojnë nxënësit për qëllimet e mësimit. Mirëpo gjatë arritjes së rezultateve të mira rrallë herë i lavdërojnë si formë stimuli apo motivimi dhe vetëm në moment. Arsimtarët planifikojnë planet e tyre duke përdorë interakcion, dhe e njëjta realizohet në mes mësimdhënësve – nxënësve si dhe raste të mësimit aktiv ka interakcion nxënës – nxënës gjatë aktiviteteve në mësim, në tërësi raportet janë të mira, bazohemi nga të dhënat që merren gjatë hospitimeve që bëhen nga ana e udhëheqësisë dhe shërbimit pedagogjik.

Shumica e mësimdhënësëve kanë qasje profesionale ndaj nxënësve, ndihmohen gjatë realizimit të mësimit të rregullt, aktiviteteve të ndryshme në shkollë, qasje të barabartë ndaj meshkujve dhe femrave (bazuar në gjini).

Në bazë të planifikimit shkolla ka procedura dhe mënyra për përcjelljen e procesit mësimor – gati se tërë vitin shkollor, analizë e përmbatjeve, rekomandime për përmirësime dhe menjanimin e lëshimeve eventuale – gjithë kjo përcillet nga strukturat udhëheqëse të shkollës, bashkëpunëtorëve profesional, por shkolla nuk ka plan konkret për evaluim të aktiviteteve me plan të veçantë. Është e nevojshme dhe duhet të hartohet dhe të miratohet procedura për përcjelljen e procesit mësimor. Shkolla dsiponon me hapsira të nevojshme për realizimin e rregullt, mirëpo ka vështërsi për realizim të sukseshëm të mësimit shtues dhe plotësues apo praktik për shkak të hapësirave për shfrytëzim gjatë ditëve të rregullta, vizitohen nëpër orë mësimore mirëpo duhet edhe më tepër bashkëpunim apo mbledhje në nivel të aktiveve profesionale me qëllim të ngritjes së kualitetit të mësimit.

Një numër i mësimdhënësve kanë realizuar një numër të madh të njësive mësimore elektronike duke e pasuruar platformën EDUINO me një numër të madh të njësive mësimore.

Shumica e arsimtarëve – pjesa më e madhe në mësim klasor rregullisht në bazë të resurseve përgaditin kënde për punimet e nxënësve apo krijimet – të cilat me të vërtet paraqesin kontributin, arritjet, pamjen pedagogjike dhe estetike të klasave si dhe inkurajimin e arsimtarëve dhe nxënësve për punë. Në përgjithësi kënaq realizimi i mësimit nëpër mësojtore të cilat janë tradicionale me mjete të pamjaftueshme por të pasuruara me punën individuale të nxënësve së bashku me arsimtarët e tyre. Higjiena është e mirë , viteve të fundit janë bërë ndryshime të mëdha në përmësimin e kushteve infrastrukturore, të cilat janë pjesë motivuese për interesimin e nxënësve në mësim.

Shkolla reealizon përmbatjet e planifikuara, programin për punën e shkollës implementon konform planifikimit dhe detyrat, obligimet që dalin dhe kërkohen nga subjektet përgjegjëse. Në shkollë ka atmosferë pune, ka klimë pune mirëpo duhet të bëhet përpjekje për sigurim të disa kushteve që janë pjesë e procesit dhe të motivohen nxënësit dhe të punësuarit për arritjet e qëllimeve të pëbashkëta individuale apo të përgjithshme me interes të shkollës dhe bashkësisë vendore, shumica e arsimtarëve i inkurajojnë nxënësit për të menduarit kritik dhe të shprehin mendimet e tyre.

Nxënësëve në përgjithësi u pëlqen mjedisi për mësim, e cila vërtetohet edhe nga numër i madhë i prindërve me cka konstatohet se klasat janë në gjendje të mirë dhe kanë motiv për mësim. Shkolla nuk ka hallë sportive pë realizimin efikas të lëndës së A.F.SH-së njëkohësisht për

realizimin e aktiviteteve dhe manifestimeve shkollore.

Kuadri arsimor dhe bashkëpunëtorët profesional mundohen të njohin dhe identifikojnë mirë nevojat arsimore dhe pengesat në procesin mësimor të çdo nxënësi të cilat identifikohen sipas arritjes të rezultateve nëpër fusha të ndryshme, sipas nevojave mund të përcjellin aktivitete dhe mundohen në menjanimin e të njëjtave.

Shkolla zbaton procedurat për nevojat e nxënësve në mësim. Mirëpo, nuk ka akte interne të brendshme, për nxënësit me nevoja të veçanta, nxënës me paraqitje emocionale. Në përgjithësi përmbushen kërkesat arsimore. Arsimtarët përgatitin detyra dhe aktivitete sipas nevojave të nxënësëve me çka motivohen. Duhet më tepër angazhim për përmbushjen e kërkesave dhe qëllimeve të këtilla. Bazuar në stilet e mësimit nga përvoja, shumica e mësimëdhësve shfrytëzojnë teknika të ndryshme interaktive për mësim dhe notim.

Shkolla zbaton normativat ligjore të cilat rregullojnë notimin e nxënësve, definuar në bazë të politikave të notimit (vlerësimit) – duhet përfshirë kodeksin e notimit, ku pjesa më e madhe e arsimtarëve janë të trajnuar për zbatimin e standardeve të notimit, në kuadër të komponentës përparimi i notimit në shkollë duke përfshirë metodat, format kriteret, faktorët etj.

Nxënësit vazhdimisht marin informata kthyese nga pjesa më e madhe e arsimtarëve për arritjet e tyre përmes instrumenteve për vlerësim, ku të njejtat vërtetohen nga prindërit. Duke zbatuar procedurat e notimit. Gjatë mësimit mundësohet detektim i plotësimit të lëshimeve të arsimtarëve si dhe përmbushja e nevojave të qëllimeve arsimore për nxënësit, nivelit të diturive duke u mundësuar të gjitha nivelet e njohjes sipas taksonomis së Blumit.(në veçanti klasat IV-IX) si dhe të mbeshtetjes në kodin e notimit.

Shkolla respekton bashkëpunimin me prindërit të cilët në kohë informohen për përparimin e fëmijëve të tyre. Procedura përfshin grumbullim të dhënave, arsimtarët japin informata kthyese e të përgjithshme për suksesin – në tremujorin e parë, gjysmvjetorin, tremujorin e tretë me fleta evidentuese të cilat nënshkruhen nga prindët, mirëpo dukshëm vërehet një numër i prindërve që nuk shprehin interesim dhe bashkëpunim sidomos në organizimin e mbledhjeve prindërore. Mirëpo, shkolla duhet të hartojë rregullore për notimin intern të nxënësve në shkollë për implementimin më efikas të kodeksit të notimit si dhe të kontribuohet në notim real dhe objektiv dhe duhet edhe më tepër të informojnë nxënësit dhe prindërit për kriteret e harmonizuara të notimit. Shkolla si institucion gjithmonë është e hapur të plotësojë nevojat dhe mënyrën më efikase për informim të prindërve me qëllim të përparimit të fëmijëve të tyre.

AKTIVITETET NË TË ARDHMEN:

Shkolla duhet të përpilojë procedurë dhe sistem për shpërblimin e të të arriturave të kuadrit arsimor dhe nxënësve.

Duhet të ndërmeren aktivitete për përfshirjen permanente të të gjithë mësimdhënësve në punën shkollore, komisioneve , ekipeve punuese me qëllim të funksionit efikas të punës ekipore në ngritjen e kualitetit të punës.

Shkolla duhet të furnizohet me kompjuterë apo llaptopa për nevoja të nxënësve për realizimin e mësimit si dhe kompjuterë më të modifikuar për nevojat e adminstrimit dhe kuadrit arsimor (Udhëheqësi, bashkëpunëtor profesional dhe kuadri arsimor).

Furnizimi i shkollës me mjete mësimore dhe rekuizita sportive

Adaptimin e kabinetit të shkencave natyrore.

Furnizimin e bibliotekës me literatur profesionale dhe plotësimin e lektyrave shkollore sipas planit.

Vetevaluimi i shkollës: SH. F.K „ Sami Frashëri " – Pirok – Bogovinë

Fusha 4: Mbështetja e nxënësve

Treguesit e cilësisë:

4.1. Kujdesi i gjithëmbaarshëm për nxënësit
4.2. Shëndeti
4.3. Ndihma këshilldhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve
4.4. Ndjekja e zhvillimit

Mbledhja e të dhënave (cilat të dhëna janë mbledhur? Cilat metoda janë shfrytëzuar ?).dhe përpunimi e dokumenteve.	
Shënoni të gjitha dokumentat që janë shfrytëzuar	**Cilat informata janë mbledhur ?**
Programet e punës të shërbimit profesional *Proçesverbalet (listat e evidencës) nga bisedat individuale, dhe anketat me nxënës dhe prindër* - *Kontratat e sigurimit*	***Fusha 4: Mbështetja e nxënësve*** ***Trequesi i cilësis: 4.1 Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit*** ***Temat: 4.1 .1.Mbrotja nga lëndimet fizike dhe fatketësi elementare*** Hapësira shkollore është e sigurtë për zhvillimin e mësimit. Shkolla ka dhe realizon aktivitete paraprake për sigurimin e nxënësve gjatë realizimit të mësimit dhe aktivitete të ndryshme gjatë ditës së punës. Infrastruktura shkollore është e sigurt dhe nuk paraqet asnjë rezik të mundshëm për lëndime. Në shkollë ndalohet dhe respektohet çfarëdo ushtrimi të dhunës. Shkolla ka krijuar politikë të bashkëpunimit duke marur parasysh iden dhe vendimet nga këshilli prindor dhe shkollor ku një numër i konsiderueshëm i nxënësve dhe arsimtarëve sigurohen për çdo vit shkollor nga sigurimi "Croatia osiguranje " me polis sigurimi. Në shkollë pjesa më madhe e arsimtarët janë të trajnuar në formën interne – trajnim për "dhënien e ndihmës së parë elementare nga fatkeqësit -evakuim" . Në shkollë funskionon kujdestaria e ditës nga kuadri arsimor dhe nxënësit. Shkolla duhet të bëjë përpjekje që të siguroj mjetet e nevojshme teknike për fatkeqësitë elementare si dhe të përgatit –" skicë- plan për evakuim"të mundshëm në raste fatkeqësie elementare dhe aktiviteteve simulimi; si dhe sigurim të mundshëm të objektit të shkollës .
- Programi vjetor për punën e shkollës për parandalim të dhunës, *- evidenca dhe informimi i shkollës përnxënës me probleme emocionale, fizike dhe sociale,*	***Tema:4.1.2. Preventiva ndaj dhunës*** Në shkollë ka aktivitete të mjaftueshme për procesin e mbrotjes ndaj dhunës, deri tani nuk ka raste të evidentuara, ka plan për realizim të temave edukative, e cila realizohet në orët e O.B.K – shkathtësi jetësore, tema të ndryshme nga shoqëria, zgjedhja e konflikteve të mundshme me anë të bisedave, respekti, toleranca etj. . Shkolla duhet të bëjë përpjekje dhe ta jetësojë më tepër projektin " parandalimin e dhunës në shkollë "

- Proçesverbalet (listat e evidencës) nga bisedat individuale, dhe anketat me nxënës dhe prindër, *- Të dhëna për tribuna dhe ligjerata të organizuara në shkollë,* *- protokollet për reagim dhe eliminim të rreziqeve,*	– 2 arsimtarë përgjegjës për implementim dhe programin e punës më efikas.. Në shkollë nuk ka raste ndërmjet arsimtarëve dhe nxënësve për maltretim fizik apo psiqik.
- *Programi vjetor për punën e shkollës* - *Të dhëna për tribuna dhe ligjerata të organizuara në shkollë* - *Rendi shtëpiak* - *Kodeksi i sjelljes* - *shënime*	***<u>Tema:4.1.3 Mbrotja nga konsumimi i duhanit, drogës dhe alkoholit</u>*** Në shkollë plotësisht respektohet procedura për ndalimin e pirjes së duhanit, janë të caktuara vendet e posaçme për duhanpirësit, ka shenja për ndalim të cilat respektohen dhe janë pjesë e rendit shtëpiak. Por, realizohen edhe tema edukative si: ,, Abuzim me lëndë narkotike si dhe alkoolit, duhanit – mbrojtja e shëndetit". Për klasat VIII – IX janë në orët e bashkësis së klasës ku mbahen ligjerata nga arsimtarët kujdestar dhe arsimtarët përgjegjës. Nga projekti i MASH-it, ligjeratë edhe nga përfaqësues të M P B. Për klasat e IX-ta.,në raste të paraqitjes së dukurive të këtilla shkolla ka ka dispozita të shkruara dhe është e gatshme për ndërmarjen e masave. (Edhe pse deri tani nuk ka patur apo vërejtur raste të tilla)
- *Programi vjetor për punën e shkollës* - *Procesverbale* - *Kërkesa* - *Raporti i evaluimeve*	***<u>Tema:4.1.4.Cilësia e ushqimit që përdoret</u>*** Objekti shkollor nuk ka kuzhinë shkollore. Nxënësit dhe të punësuarit ushqimin e sigurojnë prej shitoreve, lokaleve dhe një pjesë e vogël prej shtëpie. Shkolla nuk ka procedura për qasje në kualitetin e ushqimit që u ofrohet nxënësve dhe nuk janë ndërmarë aktivitete deri në instuticionet kompetente për kontrollime të ndryshme inspketimi (ka pasur kërkesa viteve më të hershme nga shkolla – mirëpo deri tani nuk ka përgjigje me shkrim). Shkolla ka plan dhe projekt konkret për përgatitjen e kuzhinës së shkollës, për të cilën është diskutuar në këshillin e shkollës vitet e mëparshme dhe ngelën si prioritet në të ardhmen si dhe përpjekie dhe kërkesa për kontrollimin e ushqimit nga organet kompetente.

Proçesverbale shkollore, *Ekipi inkluziv,* *Raportet e punës për nxënës me probleme emocionale, fizike dhe sociale,*	***Tema:4.1.5. Mbështetja e nxënësve me të meta fizike në zhvillim*** Shkolla respekton dhe gjithmon mbështet rastet e nxënësve me të meta fizike – (edhe pse nuk ka raste të tilla). Shkolla ka ndërmarë aktivitete ku në hyrjen e shkollës ka rrugicë, (në pjesën e hyrjes) të veçantë për nxënësit dhe personat tjerë dhe në të ardhmen duhet të përmbushen kriteret dhe standarte e objektit për personat e kësaj kategorie që lirshëm të lëvizin dhe punojnë të cilat janë të përshtatshme për nevojat e tyre. Si dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me organet kompetente dhe shoqatatat joqeveritare për ballafaqim dhe bashkëpunim të sukseshëm me këto kategori dhe grup pune.
- Evidenca e punës me qendrën sociale,kryqin e kuq,komunën *- Programi vjetor për punën e shkollës* *- Raportet e punës për nxënës me probleme emocionale, fizike dhe sociale,* *- Të dhëna për tribuna dhe ligjerata të organizuara në shkollë*	***Tema:4.1.6. Kujdesi për nxënësit që rrjedhin nga familjet në gjendje të vështirë sociale*** Për nxënësit në gjendje të vështirë sociale ka trajtim të njëjtë si me nxënësit tjerë, të cilët shfrytëzojnë ndihmë sociale, ka raste brenda vitit përfshihen në aksionin ndihmat humanitare të kryqit të kuq Nj.r.- Tetovë me ushqime, pako me numër simbolik , si dhe plotësim të kushteve tjera të nevojave (veshëmbathje etj) dhe ka bashkëpunim me bashkësin vendore për sigurim të mjeteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave të fëmijëve. Kemi raste ku ofrohen ndihma edhe nga bashkësia fetare islame e fshatit .
-Programi vjetor për punën e shkollës *Bashkëpunimi me Minstrinë e shëndetësisë,* *- Qasja në hapësirën shkollore* *Proçesverbalet e organeve të shkollës,* *-Proçesverbalet e organeve kompetente për kontrollin e*	***Treguesi i cilësisë: 4.2. Shëndeti*** ***Tema:4.2.1.Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet*** Higjiena në objektin shkollor, koridore, mësojtore është në nivel të duhur , mbahet higjienë e shtuar dhe pastërti më e madhe nëpër tualete veçanërisht gjat periudhës së pandemisë . Oborri shkollor duhet të rregullohet në mënyrë hortikulturor – , oborri shkollor mbahet i pastër si dhe kopshti shkollor me pamje të bukur estetike. Shkolla ka aktivitete konkrete – ulëset për nxënësit në oborrin shkollor, larje të objektit, rregullimin dhe mbjellje të bredhave,ndriçim në obor. Në shkollë vazhdimisht kryhet dezinfektimi i objektit dhe hapësirave shkollore (klasave, koridoreve, tualeteve) si mekanizëm mbrojtjes nga sëmundjet e ndryshme, të cilën e realizon shtëpia e shëndetit – si rekomandime nga inspektoriati higjienik dhe sanitar, sidomos

higjienës dhe shëndetit të fëmijëve	viteve të fundit me paraqitjen e pandemisë – Kovid - 19 janë respektuar të gjitha masat dhe protokolet e punës. Shkolla ka të planifikuar program për mbrojtje nga sëmundjet infektive dhe e realizon në bazë të dinamikës për realizim, të njëjtat realizohen edhe nga përmbatjet programore të orës së bashkësis së klasës – shkathtësi jetësore. Për kujdesin e shëndetit vitet e mëparshme shkolla ka realizuar plane dhe të njëjtat i ka zbatuar. Në shkollë rregullisht realizohen kontrollet sistematike, vaksinimet si dhe kontrollim të rregullt të punësuarve nga shtëpia e shëndetit - Tetovë duke respektuar normativat ligjore. Shkolla një herë në vit bën dezinfektimin, deratizimin dhe dezinsekcimin (D D D). Shkolla gjatë kohës së pandemisë ka respektuar mbajten e distancës dhe maskave, dezinfektimin, për parandalimin e pandemisë duke e respektuar protokollin për punë. Gjatë viteve të fundit janë të realizuar vakcinimet e rregullta si dhe kontrollimet dentale të nxënësve nga institucionet kompetente si dhe kontrolli sistematik dhe sanitar i të punësuarve gjatë muajve tetor, nëntor 2020.
- *Programi vjetor për punën e shkollës* - *Proçesverbale për bashkëpunim me nxënës dhe prind* - *Raportet e punës për nxënës me probleme emocionale, fizike dhe sociale,*	***Tema:4.2.2. Kujdes për nxënësit me probleme shëndetësore*** Shkolla kujdeset për nxënësit me probleme shëndetësore – edhe pse është numër shumë i vogël, intervenohet në moment, ndihmohet dhe këto raste realizohen me konsultim, bashkëpunim me prindërit. Për udhëzime të mëtutjeshëm shkolla mer të dhëna për numër të nxënësve për shëndetin e fëmijëve (me probleme) mirëpo në disa raste nuk ka informata apo të dhëna për nxënësit me probleme shëndetësore për dëshmi apo të dhëna nga familjarët për gjendjen shëndetësore të fëmijëve që të hartoj plan dhe programe të veçant - të ballafaqimit me situata të tilla.

- *Programi i punës shkollës për orientim profesional të nxënësve* - *Ditarët e klasave,* - *Fletushkat, ligjeratat* - *Anketa dhe intervista për nxënës dhe prindër,* - *Informata të përgatitura nga shërbimi profesional dhe të plasuara përmes mediumeve ekzistuese në shkollë,* -	***Trequesi i cilësis: 4.3 Ndihma këshilldhënëse për arsimimin e mëtejshëm të nxënësve*** ***Temat:4.3.1. Ofrimi i ndihmës për zgjedhjen e profesionit / institucionit për arsim të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim*** Shkolla u siguron nxënësve informata të qarta, të sakta, për shkollimin e mëtutjeshëm. Nxënësve u ofrohet ndihmë, udhëzime apo këshilla për zgjedhjen e profesionit gjegjësisht shkollimin e mëtutjeshëm. Për ofrim të ndihmës në orët e klasës zhvillohen biseda të tilla me program të veçantë: – Realizim të anketës për orientim profesional për nxënës – „Zgjedhje e profesionit – ardhmëri e sigurt” - ligjeratë (diskutim) – Informim për konkurset nga MASH – kriteret për regjistrim dhe afatet – Konsulltime individuale me nxënës dhe prind, këshillime profesionale. Pedagogu bazuar në kërkesat ligjore ka realizuar tema për ”Orientimin profesional”, e cila realizohet çdo vit në bazë të planifikimit, përmes platformës Teams Shkolla duhet më tepër të kontriboj që nxënësve me tepër tu ofrohen ndihme në drejtim të dhënies së ndihmës për zgjedhje të profesionit – në drejtim të aftësive profesionale, përvojave dhe nevojave të kohës, aftësive që kërkon tregu i punës.
- *Evidenca e punës* - *Proçesverbalet nga bisedat individuale me prindër dhe nxënës* - *Informata të përgatitura nga shërbimi profesional dhe të plasuara përmes mediumeve ekzistuese në shkollë,*	***Temat:4.3.2. Kujdesi për nxënësit me vështërsi emocionale*** Problemin e nxënësve me vështërsi emocionale shkolla, drejtori, arsimtarët, shërbimi, profesional intervenohet në kohë, ndihmohet dhe informon prindërit e nxënësve për situata të paraqitjeve të tilla – të cilat në të shumëtn e rasteve janë paraqitje të natyrës së moshës, psikologjike e sociale të cilat deri tani nuk ka të evidentuar. Duhet të hartohen programe të veçanta – dhe duhet të ndërmeren aktivitete për trajnim të një numri të arsimtarëve – të cilët do të aftësohen për realizim të këtyre procedurave apo rasteve edhe pse më tepër realizohet nga shërbimi profesiona i shkollës

- *Evidenca e nxënësve që kanë shkuar dhe nxënësve të ardhur,* - *Evidenca e punës së pedagogut, statistikat, raportet .* - *Shqyrtimi i evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik,*	***Trequesi i cilësis: 4.4 Ndjekja e përparimit*** ***Tema: 4.4.1 Mbatja e evidencës për përparimin individual të nxënësve*** Bashkëpunëtorët profesional – pedagogu dhe pjesa më e madhe e arsimtarëve me ditar të veçantë mbajnë evidencë për të arriturat e nxënësve e cila në kontinuitet përcillet gjatë vitit shkollor, si dhe mbahet evidencë e mirfilltë për sjelljen dhe rregullshmërinë e nxënësve në dosiet individuale personale të arsimtarëve dhe dokumentacioni shkollor. Aktivitete tjera që realizohen: informim të prindëve, evidencë për përcjelljen e mësimit (rregullshmërin), bashkëpunim me prindër, pjesëmarrje në gara, përcjellja e konkurseve, etj.
- *Ditari i punës* - *Raporti i punës* - *Evidenca e punës së pedagogut, statistikat, raportet .* - *Evidenca e nxënësve që kanë shkuar dhe nxënësve të ardhur,* -	***Tema: 4.4.2 Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve*** Pjesa më e madhe e mësimdhënësëve përgadisin raporte dhe analiza në të gjitha periudhat kualifikuese, statistika, fleta evidentuese(kujdestarët e klasave), duke u mbështetur në evidencat personale me evidencë dhe dokumentacion pedagogjik: e – ditar, të cilat të dhëna shërbejnë si raporte, analiza krahasuese, raporte pranë organeve dhe trupave shkollor, B.ZH.A., M.A.SH. të cilat rezultate shfrytëzohen për diksutim apo rekomandime për përmisim të rezultateve. Analizat për realizimin e nxënësve, paraleleve, lëndë më detalisht janë të prezantuara në fushën 2 – arritjet e nxënësve, mirëpo shkolla duhet të kontribuojë ose të bëjë përpjekie sidomos në ngritjen e suksesit të përgjithshëm të shkollës dhe individual të nxënësve, e cila për tre vitet e fundit është përpunuar mirë dhe diskutuar me rekomandime konkrete.

Shëno metoda tjera si janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarja: Kush ishte i përfshirë në këto informata	Cilat informata janë mbledhur?
Anket	***Ekipi***	**ANKETË PËR ARSIMTARËT** **TEMA: PËRKRAHJA E NXËNËSVE** Gjatë përgjigjjeve keni tre opsione të mundëshme:"PO", "JO", dhe "NUK E DI". (Rretho atë që mendon se mund të jetë e saktë) **ANKETË PËR NXËNËS-** Anketa është përpunuar në Forms dhe është shpërndarë përmes platformës Teams. Realizuar nga arsimtarja Luljeta Shabani dhe pedagogu i shkollës Memed Mehmedi. Janë përgjigjur gjithsejt 36 respondent, rezultatet e përgjigjeve janë dhënë më poshtë me diagram shtyllortë reale).  Nxënës të nderuar, përgjigjet tuaja të sinqerta do të na ndihmoj në rezultate sa më të sakta dhe sa më konkrete. Ata do të jenë anonime (pa emrat Tuaj). Ju do të përgjigjeni duke vendosur shenjën ☑ tek hapësirat që ju mendoni se duhet. Pyetjet janë në vijim!

Nr.		**Pajtohem plotësisht**	**Pajtohem**	**Nuk pajtohem**	**Aspak nuk pajtohem**	**Nuk e di**
1.	A janë të hapur mësuesit për ndihmë, bashkëpunim, përkrahjen dhe stimulimin tuaj?	44%	23%	33%	0%	0%
2.	A janë prindërit tuaj të thirrur nga shkolla për të bashkëpunuardhe për tu informormuar ato në kohë, për ngjarjet që ndodhin në shkollë?	49%	13%	38%	0%	0%
3.	A i menaxhojnë mirë mësuesit orët mësimore?	30%	41%	29%	0%	0%
4.	A vijnë prindërit e tu rregullisht në shkollë atëherë kur i thërret mësimdhënësi apo drejtori?	49%	13%	38%	0%	0%
5.	A merret parasysh edhe mendimi i juaj për vendosjen e rregullores në klasë?	37%	29%	34%	0%	0%
6.	A e respektoni rregulloren e miratuar nga ju së bashku me arsimtarët për sa i përket sjelljes gjatë mësimot me prezencë fizike apo mësimit online?	25%	47%	28%	0%	0%
7.	A ke të drejtë të flasësh lirshëm me mësimdhënësit e tu për të gjitha problemet e tua?	45%	19%	36%	0%	0%
8.	A krijojnë mësimdhënësit klimë të mirë në klasë dhe a i arrijnë objektivat mësimore?	30%	41%	29%	0%	0%
9.	Kryetarët e klasave a bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët (nxënësit), arsimtarët, drejtorin, organet tjera kompetente?	87%	13%	0%	0%	0%
10.	A janë organet e shkollës, të hapur dhe të gatshëm për bashkëpunimin?	33%	28%	39%	0%	0%
11.	A u ndihmojnë mësimdhënia aktive online dhe zbatimi i TIK-ut gjatë nxënies së njësive të reja?	26%	44%	30%	0%	0%

Anketë	***Ekipi***	
Rezultatet: Këtu duhet të arsyetohen anët e juaja të forta dhe të dobëta në formë të shkurtër		
Anët e forta: ✓ ***Objekti dhe hapësirat shkollore janë të sigurta për zhvillimin e mësimit,*** ✓ ***Në shkollën tonë nuk ka raste të paraqitjes së dhunës dhe për të njejtat realizohen tema në kuadër të temave mësimore OBK si dhe realizim të programit për parandalimin e dhunës në shkollë,*** ✓ ***Shkolla siguron permanent të punësuarit dhe nxënësit me pëlqim paraprak me prindërit .*** ✓ ***Shkolla respekton procedurat për dezinfektim dhe kontrolle të rregullta për të punësuarit .*** ✓ ***Shkolla respekton dispozitat e nxënësve gjatë lëndimeve serioze, smundjeve kronike si dhe mban evidencë gjatë procesit mësimor,*** ✓ ***Ekziston interaksion i shkëlqyer në raport nxënës-mësimdhënës gjatë realizimit të mësimit dhe aktivitetet e tjera jashtamësimore,*** ✓ ***Shkolla ka bashkëpunim të mirë me shkollat e mesme , orientime dhe këshillimi profesionale bazuar në tregun e punës .*** ✓ ***Higjiena është në nivelin e duhur dhe rregullisht realizohen tema kushtuar sëmundjeve të ndryshme .***		
Anët e dobëta: ✓ ***Duhet të rregullohet hyrje e vaçantë dhe parking për personat me envaliditet të veçantë .*** ✓ ***Shkolla duhet të bëjë rregullimin e një pjese të oborrit të shkollës për shfytëzimin e nxënësve si dhe ngritjen e vetëdijes për komunikacion.*** ✓ ***Përpjekje për procedurën e planit për evakuim të shkollës .***		

Analiza e rezultateve

Hapsira shkollore është e sigurtë për zhvillimin e mësimit. Shkolla ka dhe realizon aktivitete paraprake për sigurimin e nxënësve gjatë realizimit të mësimit dhe aktivitete të ndryshme gjatë ditës së punës. Infrastruktura shkollore është e sigurt dhe nuk paraqet asnjë rezik të mundshëm për lëndime. Në shkollë ndalohet dhe respektohet çfarëdo ushtrimi të dhunës. Shkolla ka krijuar politikë të bashkëpunimit duke marur parasysh iden dhe vendimet nga këshilli prindor dhe shkollor ku një numër i konsiderueshëm i nxënësve dhe arsimtarëve sigurohen për çdo vit shkollor nga sigurimi " Croatia osiguranje " me polis sigurimi. Në shkollë pjesa më madhe e arsimtarëve janë të trajnuar në formën interne – trajnim për "dhënien e ndihmës së parë elementare nga fatkeqësit -evakuim" . Në shkollë funskionon kujdestaria e ditës nga kuadri arsimor dhe nxënësit. Shkolla duhet të bëjë përpjekje që të siguroj mjetet e nevojshme teknike për fatketësit elementare si dhe të pregadit –" skic- plani për evakuim"- të mundshëm në raste fatkeqësie elementare dhe aktiviteteve simulimi si dhe sigurim të mundshëm të objektit të shkollës .

Në shkollë ka aktivitete të mjaftueshme për procesin e mbrotjes ndaj dhunës, deri tani nuk ka raste të evidentuara, ka plan për realizim të temave edukative , e cila realizohet në orët e OBK – shkathtësi jetësore,tema të ndryshme nga shoqëria,zgjedhja e konflikteve të mundshme me anë të bisedave ,respektit, ,tolerancës etj. Shkolla duhet të bëjë përpjekje dhe ta jetësoj më tepër projektin" parandalimin e dhunës në shkollë "

– 2 arsimtarë përgjegjës për implementim.dhe programin e punës më efikas.

Në shkollë nuk ka raste ndërmjet arsimtarëve dhe nxënësve për maltretim fizik apo psiqik.

Në shkollë plotësisht respektohet procedura për ndalimin e prijes së duhanit, janë të caktuara vendet e posaçme për duhanpirësit, ka shenja për ndalim e cila respektohet dhe është pjesë e rendit shtëpiak. . Por realizohen tema edukative ,, Keqpërdorimi i drogës, alkooholit, duhanit – mbrojtja e shëndetit" për klasat VIII –IX janë në orët e bashkësis së klasës dhe mbahet ligjerat nga Arsimtar nga projekti i MASH-it,ligjerat edhe nga përfaqësues të M P B. Për klasat e IX-ta,në raste të paraqitjes së dukurive të këtilla shkolla ka në dispozita të shkruara dhe është e gatshme për ndërmarjen e masave .(edhe pse deri tani nuk ka patur apo vërejtur raste të tilla)

Objekti shkollor nuk ka kuzhinë shkollore. Nxënësit dhe të punësuarit ushqimin e sigurojnë prej shitoreve, lokaleve dhe një pjesë e vogël prej shtëpie. Shkolla nuk ka procedura për qasje në kualitetin e ushqimit që u ofrohet nxënësve dhe nuk janë ndërmarë aktivitete deri në instuticionet kompetente për kontrollime të ndryshme inspketimi (ka pasur kërkesa viteve më të hershme nga shkolla – mirëpo deri tani nuk ka përgjigje me shkrim). Shkolla ka plan dhe projekt konkret për pregaditjen e kuzhinës së shkollës.Për të cilën është diskutuar ë këshillin e shkollës vitet e mëparshme dhe ngelën si prioritet në të ardhmensi dhe përpjekje dhe kërkesa për kontrollimin e ushqimit nga organet kompetente.

Shkolla respekton dhe gjithmon mbështet rastet e nxënësve me të meta fizike – (edhe pse nuk ka raste të tilla). Shkolla ka ndërmarë aktivitete ku në hyrjen e shkollës ka stazë(hyrje) të veçantë për nxënësit dhe personat tjerë dhe në të ardhmen duhet të përmbushen kriteret dhe standarte e objektit për

personat e kësaj kategorie që lirshëm të lëvizin dhe punojnë të cilat janë të përshtatshme për nevojat e tyre. Si dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me organet kompetente dhe shoqatatat joqeveritare për ballafaqim dhe bashkëpunim të sukseshëm me këto kategori dhe grup pune.

Për nxënësit në gjendje të vështirë sociale ka trajtim të njëjtë si me nxënësit tjerë,të cilët shfrytëzojnë ndihmë sociale, ka raste brenda vitit përfshihen në aksionin ndihmat humanitare të kryqit të kuq nj.r.- Tetovë me ushqime,pako me numër simbolikë . si dhe plotësim të kushteve tjera të nevojave dhe ka bashkëpunim me bashkësin vendore për sigurim të mjeteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave të fëmijëve. Kemi raste ku ofrohen ndihma edhe nga bashkësia fetare islame e fshatit .

Higjiena në objektin shkollor, koridore, mësojtore është në nivel të duhur , dhe pastërtia e duhur nëpër tualete .
Oborri shkollor duhet të rregullohet në mënyrë hortikulturor – , oborri shkollor mbahet i pastër si dhe kopshti shkollor me pamje të bukur estetike . Shkolla ka aktivitete konkrete – ulëset për nxënësit në oborrin shkollor,ndriçim për rreth oborrit shkollor , larje të objektit, rregullimin dhe mbjellje të bredhave. Në shkollë permanent kryhet dezinfektimi i objektit dhe hapësirave shkollore (klasave, koridoreve, tualeteve) si mekanizëm mbrojtjes nga sëmundjet e ndryshme, të cilën e realizon shtëpia e shëndetit – si rekomandime nga inspektoriati higjienik dhe sanitar.sidomos viteve të fundit me paraqitjen e pandemisë-kovid 19 janë respektuar të gjitha masat dhe protokolet e punës.
Shkolla ka respektuar mbajten e distancës dhe maskave , dezinfektimin, për parandalimin e pandemisë duke e respektuar protokollin për punë.
Gjatë viteve të fundit janë të realizuar vakcinimet e rregullta si dhe kontrollimet dentale të nxënësve nga institucionet kompetente si dhe kontrolli sistematik dhe sanitar i të punësuarve gjatë muajve tetor, nëntor 2020.

Shkolla ka të planifikuar program për mbrojtje nga sëmundjet infektuese dhe të njëjtën e realizon në bazë të dinamikës për realizim, të njëjtat realizohen edhe nga përmbatjet programore të orës së bashkësis së klasave – shkathësi jetësore. Kujdesi për shëndetin vitet e mëparshme shkolla ka realizuar plane dhe të njëjtat i ka zbatuar. Në shkollë rregullisht realizohen kontrollet sistematike, vaksinimet si dhe kontrollim të rregullt të punësuarve nga shtëpia e shëndetit- Tetovë duke respektuar normativat ligjore.Shkolla një herë në vit bën dezinfektimin , deratizimin dhe dezinsekcimin (D D D).

Shkolla kujdeset për nxënësit me probleme shëndetësore – edhe pse është numër shumë i vogël, intervenohet në moment, ndihmohet dhe këto raste realizohen me konsultim, bashkëpunim me prindërit. Për udhëzime të mëtutjeshëm shkolla mer të dhëna për numër të nxënësve për shëndetin e fëmijëve (me probleme) mirëpo në disa raste nuk ka informata apo të dhëna për nxënësit me probleme shëndetësore për dëshmi apo të dhëna nga familjarët për gjendjen shëndetësore të fëmijëve që të hartoj plan dhe programe të veçant - të ballafaqimit me situata të tilla.

Shkolla u siguron nxënësve informata të qarta, të sakta, për shkollimin e mëtutjeshëm. Nxënësve u ofrohet ndihmë, udhëzime apo këshilla për zgjedhjen e profesionit gjegjësisht shkollimin e mëtutjeshëm. Për ofrim të ndihmës në orët e klasës zhvillohen biseda të tilla me program të veçantë:

– Realizim të anketës për orientim profesional për nxënës
– ,,Zgjedhje e profesionit – ardhmëri e sigurt" - ligjeratë (diskutim)
– Informim për konkurset nga MASH – kriteret për regjistrim dhe afatet
– Konsulltime individuale me nxënës dhe prind, këshillime profesionale.

Pedagogu bazuar në kërkesat ligjore ka realizuar tema: "Orientimin profesional", e cila realizohet çdo vit në bazë të planifikimit, përmes platformës Microsoft Teams

Shkolla duhet më tepër të kontriboj që nxënësve me tepër tu ofrohen ndihme në drejtim të dhënies së ndihmës për zgjedhje të profesionit – në drejtim të aftësive profesionale, përvojave dhe nevojave të kohës, aftësive që kërkon tregu i punës.

Problemin e nxënësve me vështërsi emocionale shkolla , drejtori, arsimtarët, shërbimi, profesional intervenohet në kohë, ndihmohet dhe informon prindërit e nxënësve për situata të paraqitjeve të tilla – të cilat në të shumëtn e rasteve jan paraqitje të natyrës së moshës, psikologjike e sociale të cilat deri tani nuk ka të evidentuar. Duhet të hartohen programe të veçanta – dhe duhet të ndërmeren aktivitete për trajnim të një numri të arsimtarëve – të cilët do të aftësohen për realizim të këtyre procedurave apo rasteve edhe pse më tepër realizohet nga shërimi profesiona i shkollës.

Bashkëpunëtorët profesional – pedagogu dhe pjesa më e madhe e arsimtarëve me ditar të veçantë mbajnë evidencë për të arriturat e nxënësve e cila në kontinuitet përcillet gjatë vitit shkollor, si dhe mbahet evidencë e mirfilltë për sjelljen dhe rregullshmërin e nxënësve në dosjet individuale personale të arsimtarëve dhe dokumentacioni shkollor.Aktivitete tjera që realizohen:informim të prinërëve, evidencë për përcjeljen e mësimit(rregulshmërin),bashkëpunim me prindër ,pjesmarje në gara,përcjelja e konkurseve.

Pjesa më e madhe e mësimdhënësëve përgadisin raporte dhe analiza në të gjitha periudhat kualifikuese, statistika, fleta evidentuese(kujdestarët e klasave), duke u mbështetur në evidencat personale me evidencë dhe dokumentacion pedagogjik: e –ditar, të cilat të dhëna shërbejnë si raporte, analiza krahasuese, raporte pranë organeve dhe trupave shkollor, BZHA, MASH. të cilat rezultate shfrytëzohen për diksutim apo rekomandime për përmisim të rezultateve. Analizat për realizimin e nxënësve, paraleleve, lëndë më detalisht janë të prezantuara në fushën 2 – arritjet e nxënësve, mirëpo shkolla duhet të kontriboj ose të bëjë përpjekje sidomos në ngritjen e suksesit të përgjithshëm të shkollës dhe individual të nxënësve, e cila për tri vitet e fundit është përpunuar mirë dhe diskutuar me rekomandime konkrete.

AKTIVITETET NË TË ARDHMEN:

Shkolla duhet të bëjë procedura për sigurim të objektit dhe ndërtimin e sallës sportive .
Nxitje dhe aktivizim më të madh të nxënësve për pjesëmarrje në gara të ndryshme .
Furnizimi i shkollës me mjete , paisje didaktike për nevojat e nxënësve të Kl. I – IV për realizimin e qëllimeve programore bazuar në konceptin e ri .

Vetevaulimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri " – Pirok – Bogovinë

Fusha 5. Atmosfera shkollore dhe marëdhëniet në shkollë

Treguesit e cilësisë:

5.1 Atmosfera shkollore dhe marrdhëniet në shkollë
5.2 Provimi i arritjeve
5.3 Barazia dhe drejtësia
5.4 Marrëdhëniet partnere me prindërit dhe me bashkësisë lokale dhe komunitetin afarist

Vetevaulimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri " – Pirok – Bogovinë

Fusha 5. Atmosfera shkollore dhe marëdhëniet në shkollë

Trequesi i cilësis: 5.1 Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	
Dokumentet e kontrolluara (të dhënat burimore)	***Informatat të cilat janë mbledhur***
Intervistë me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, Evidenca pedagogjike për masat e shqiptuara pedagogjike,	***Tema:5.1.1 Prestigji / imazhi i shkollës*** Imazhi i shkollës tërësisht kënaqën standartet e funksionimit te institucionit edukativo arsimor, me cka pjesa me e madhe e të punsuarve kontribojnë në afirmimin e shkollës, raporte në mes të arsimtarëve dhe nxënësve janë të mira të cilat bazohen në respekt të ndërsjelltë. Kuadri arsimor gëzon respekt, shumica dhe numri i madhë i nxënësve dhe prindërve e cila sjellë në identifikim të shkollës e cila respektohet me ndjenjë të kënaqësis dhe sigurisë së punës efikase, bazuar në realizimin e vizionit dhe misionit shkollor.
Dokumente të shkruara, Kodi i sjelljes, rregulli shtëpiak i shkollës.	***Tema:5.1.2 Kodi i sjelljes*** Në shkollë ka procedurë për kodin e sjelljes për nxënësit dhe të punësuarit, - Kodi përmban dhe përgëzon respektin në mënyrë të barabartë. Mosha, gjininë, nxënësit me dukuri paraqitjeve emocionale dhe përfshirjen statutit social, kodi i sjelljes është i miratuar nga të gjithë të punsuarit dhe është pjesë përbërse normat për punë dhe kodeksin etik të shkollës, të gjithë kanë participuar në hartimin dhe e njëjta respektohet nga të gjithë strukturat shkollore.

- *Intervistë për nxënës dhe arsimtar* - *Raportet e punës* - *Raportet e fundit të vitit shkollor*	***Tema:5.1.3 Atmosfera e shkollës*** Në bazë të kushteve, të cilën realizohet procesi edukativo-arsimor konstatim i përgjithshëm se në shkollën tonë ka klimë pozitive respekt, ndjesi të kënaqësisë nga shumica për realizim të aktiviteteve të punës në shkollë si dhe arritjet e përbashkëta, trajtim të barabartë, bashkëpunim profesional.

- *Rrregulli shtëpiak i shkollës.* - *Proceset nga mbledhja e këshillit të arsimtarëve* - *Dokumentacioni shkollor* - *Udhëzimi për mënyrën e shqiptimit të masave pedagogjike në shkolla*	***Tema:5.1.4 Sjellja dhe diciplina në shkollë*** Disciplina në përgjithsi kënaqën me çka vërehet dhe ekziston atmosferë pune gjithë kohës së mësimit, dhe aktiviteteve jashtëmësimore, nuk janë hasur konflikte të rënda, shkolla resptekton dhe shqipton masat pedagogjike bazuar me ligjin për arsim fillor për nxënësit që pengojn gjatë realizimit të procesit mësimor dhe atyre që kanë qëndrim jo të drejtë ndaj vlerave shkollore. Në këtë drejtim ndihmon edhe bashkësia e nxënësve në nivel shkollor në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në shkollë,ka raste moskënaqësie por të njëjtat kanë përmirsime.
- *Intervista me nxënës dhe arsimtar*	***Tema:5.1.5 . Participimi i nxënësve në zgjedhjen e problemeve dhe marjen e vendimeve*** Participimi i nxënësit në zgjedhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve si zakonisht respektohet , japin mendime, ide, merren parasysh si vërejtje apo lëvdata për punën dhe jetën në shkollë në bisedë dhe takime në klasë u jepet mundësia të njejta ti shprehin me shkrim përmes kutisë postale shkollore e cila kontrollohet nga drejtori dhe të njëjtat shqyrtohet, ku ka bazë të cilat kontribuojnë në ngritjen e cilësisë. Në funksion aktiv është bashkësia e nxënësve apo parlamenti i nxënësve si organ i barabartë në shkollë – përmes mbledhjeve informohet për programin në punën e shkollës, aktivitetin, sukseset dhe të gjitha aktivitetet shkollore dhe të gjitha propozimet si anë të dobëta të shkollës apo kënaqësit si anë të forta merren

	parasysh dhe të njejtat shërbejnë për analiza të mëtutjeshme të përmirësimit të punës dhe suksesit shkollor.

Vetevaulimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri " – Pirok – Bogovinë
Fusha 5. Atmosfera shkollore dhe marëdhëniet në shkollë

Trequesi i cilësis: 5.2 Promovimi i arritjeve	
Dokumentet e kontrolluara (të dhënat burimore)	**Informatat të cilat janë mbledhura**
– *Raportet dhe analizat* - *Evidenca dhe dokumentacioni i garave* - *Bisedat me mësimdhënësit dhe shërbimin profesional*	***Tema:5.2.1 Promovimi i arritjeve personale të nxënësve*** Arritjeve të nxënësve shkolla ju kushton rëndësi dhe vëmendje të vecantë, shkolla disponon me dëshmi të mjaftueshme për promovimin personal të nxënësve për arritjet e tyre, mirëpo kuadri arsimor duhet më tepër të lëvdojnë nxënësit gjatë rezultateve. Nxitet kreativiteti i motivimi për pjesmarje në gara, shkollore, komunale dhe regjionale me aspirata më suksese më të larta individuale dhe shkollore. Aspekti i mënyrës së organizimit planifikimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve në gara është viteve të fundit më i madh interesimi dhe në mënyrën e pjesëmarrjes së nxënësve në gara me anë të dhënies së mundësisë së testimit intern si bazë e rezultateve dhe selektimit në gara e mëtutjeshme mirëpo ekzistojnë lëshime apo mospjesëmarrje nga disa lëndë të cilat shkolla duhet të ndërmer aktivitete për përfshirjen e nxënësve mënyrë të barabartë dhe realizimin e detyrave të çdonjërit në bazë të rregullores së punës.
– *Programi për punën e shkollës raportet dhe*	***Tema:5.2.2 Promovimi arritjeve në emër të shkollës*** Në funksion legjislativ viteve të fundit obligimet dhe ndarja e detyrave të cdo arsimtëri në lidhje me

analizat, – *Evidenca dhe dokumentacioni shkollor* – *Evidenca e nxënësve, që kanë shkuar dhe atyre që kanë ardhur,* – *Raportet nga realizimi i garave* – *Lëvdata, mirënjohje*	organizimin dhe realizimin e garave si formë e promovimit të vlerave dhe arritjeve në nivel të shkollës dukshëm janë përmirsuar si rezultatet i ekipeve shkollore, informimit në kohë nga organet përgjegjsive si dhe shoqatat e akredituara për organizime të tilla. Arritjet e nxënësve dhe kuadrit arsimor në emër të shkollës – janë: • Bashkëpunimi i vazhdueshëm me të gjitha subjektet • Planifikimi dhe realizimi i projekteve të shkollës • Implementimi i arritjeve në cilësi të infrastrukturës • Rregullimin e mirëmbajteve objekteve të brendëshme shkollore • Pjesëmarrja e nxënësve në gara shkollore, komunale dhe regjionale

Vetëevaulimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri " – Pirok – Bogovinë

Fusha 5. Atmosfera shkollore dhe marëdhëniet në shkollë

Trequesi i cilësis: 5.3 Barazia dhe të drejtat	
Dokumentet e kontrolluara (të dhënat burimore)	**Informatat të cilat janë mbledhur**
– *Evidenca dhe dokumentacioni shkollor për përfshirjen e nxënësve në aktivitetet jashtamësimore* – *Programi për realizimin e temësnë lëndën e Shkathtësive jetësore*	***Tema:5.3.1 Njohja e të drejtave të fëmijëve*** Të drejtat e fëmijëve realizohen përmes disa orëve të bashkësisë së klasëve si pjesë e shkathësive jetësore, orëve të arsimit qytetar, si dhe shkolla realizon planifikimin e programit " Të drejtat e mia" për nxënësit e tre cikleve të arsimit fillor nëntëvjecar. I-III, IV – VI dhe VII-IX. Ku realizohen tema të përshtatshme për moshën e nxënësve e cila bazohet ne doracakun, mirëpo krahasuar për nevojat e njohjes, informative duhet të bëhet përpjekje për më shumë aktiviteteve në lidhje me të drejtat e fëmijëve, sindikatat, ligjin, konventat ndërkomtare, diskriminim etj.
– *Anketat dhe intervistat me nxënësit, prindërit dhe shërbimit profesional,* – *Ditari për punën e shërbimit profesional*	***Tema: 5.3.2. Trajtimi i barabartë i drejtë dhe i barabartë i të gjithë nxënësve*** Shkolla mirë e vlerson në bazë procedurave dhe aktiviteteve evauluese ku mundohet të zbatoj kulturë mësimore të barabartë për të gjithë nxënësit në aspektin gjinor, nuk ka raste deskriminimi por e tëra respektohen në të gjitha fushat arsimore dhe edukative.

– *Programi i punës së shkollës,* – *Projekti i PINA* – *Raportet e punës së shkollës*	***Tema:5.3.3. Pranimi dhe promovimi i multikulturalizmit*** ***Shkolla është e përfshirë në realizimin e projektit –PINA-USAID dhe mësimi realizohet vetëm në një gjuhë-gjuhë shqipe.*** _ Shkolla në bazë të aktiviteteve konstatorn se elementet dhe prania e vlerave multikulturore edhe pse vërehet dhe haset shumë pak nuk paraqesin pengesë por përkundrazi ngjalli interesim nga shumica.. Gjatë procedurave të informimit të arsimtarëve përmes komunikimeve të ndryshme (informime, vendime, rregullore, kërkesa etj) – përveq përmbatjeve programore nëpër lëndë të ndryshme, planin apo prezantimin e faktorëve tjerë – nuk ka raste të përvojave negative. Realizim të projektit për integrimin ndëretnik në masë të madhe janë realizuar aktivitete të përbashkëta dhe kanë shërbyer si shembull i mir i vlerësimit të shkollës.

Vetëevaulimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri " – Pirok – Bogovinë

Fusha 5. Atmosfera shkollore dhe marëdhëniet në shkollë

Trequesi i cilësis: 5.4 Marrëdhënie partnere me prindërit dhe me bashkësinë lokale dhe komunitetin afariste	
Dokumentet e kontrolluara (të dhënat burimore)	**Informatat të cilat janë mbledhur**
- *Raporti i punës së shkollës (gjysmëvjetor, vjetor)* - *Proçesverbalet e këshillit të prindërve dhe mbledhjeve prindërore* – *Anketat dhe intervistat me nxënësit prindërit dhe shërbimit profesional,* - *Evidence e thirjeve individuale*	***Tema: 5.4.1.Bashkëpunimi i shkollës me prindërit*** Shkolla përfshinë më tepër prindërit në punën e shkollës si subjekte të barabartë, aktivitetet të ndryshme, në kuadër të rregullave ligjore për pjesmarje në aktivitetet e punës dhe vendimarje në këshillin prindror dhe këshillin e shkollës. Bashkpunimi i shkollës me prind dëshmohet përmes takimeve individuale dhe mbledhjeve prindrore me kujdestarët e klasës informime të rregullta për arritjet dhe suksesin e tyre. Ka raste të bashkpunimit në realizimi të akcioneve të ndryshme, aktivitete pune, manifestime etj mirëpo duhet të ndërmeren aktivitete konkrete për participimin e prindërve në shkollë jo vetëm në pjesmsmrjen formale(këshill të shkollës dhe këshillin prindor).

- *Programi për bashkëpunim* - *Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike (për punën e dobishme shoqërore, për veprimtari kulturore publike)* - *Qasja në web faqen e shkollës, marrja e informatave në kohë pandemie*	***<u>Tema: 5.4.2. Bashkëpunimi me bashkësinë lokale</u>*** Shkolla ka bashkëpunim të mirë me bashkësinë lokale, për organizimin dhe realizimin të aktiviteteve të ndryshme, manifistimeve, projekteve të cilat implementohen, informime të rregullta përmes komunikimeve elektronike, është në bashkpunim të mirfilltë me udhëheqësis së bashkësisë fetare së fshatit dhe qytetarët për çdo lloj aktiviteti që shërben dhe është në dobi të të gjithëve si dhe klubin futbolistik të fshatit, ndihmojnë në aktivitete të ndryshme vullnetare..
- *Dokumentacioni për donacionet dhe sponsorimet e fituara* – *Anketat dhe intervistat me nxënësit prindërit dhe shërbimit profesional,* – *Proçesverbalet dhe vendimet nga mbledhjet e Këshillit shkollor* – *Marrëveshja me bashkësinë afariste* – *Projektet e shkollës në funksion të zhvillimit të shkathtësive praktike të nxënësve,* – *Proçesverbalet dhe vendimet nga mbledhjet e këshillit shkoll* - *Procese të shkruara* - *Evidencë*	***<u>Tema:5.4.3. Bashkëpunimi me bashkësinë afariste dhe sektorin joqeveritar</u>*** Me komunitetin afarist shkolla ka bashkpunim në realizimin aktiviteteve në shkollë, infrastrukturë, projekte , investime të një numri afaristësh dhe zejtarëve të cilët mundohen të japin kontributin e tyre në përmirsimin e kushteve në shkollë, në aktivitetet e punës në forumun ne bashkësi, në eko – programe, etj. Me sektorin qeveritar ka takime kur n ë bazë të projekteve duhet të ndihmohet në raste të ndryshme sidomos me Kryqin e kuq – ka donacione të ralla që u dedikohet nxënësve sidomos atyre në ra përfshirje të dobët.,mirëpo duhet të përkrhet vizita më të shpeshta në kompanitë private të rrethinës për njohuri më të zgjeruara.

Metoda për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja në mbledhjen e të dhënave	Informatat të cilat janë mbledhur
Anketë	*Ekipi*	**Shkolla fillore komunale "Sami Frashëri" f.Pirok** **PYETËSOR PËR PRINDËR** **ATMOSFERA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLË** **Ju lutem që gjatë plotësimit të pyetësorit anonim të jeni sa më të sinqertë me qëllim që ky pyetësor të arrijë qëllimin e paraparë. Shënoni "√", në celulën para deklaratës së saktë.** Anketa është përpunuar në Forms dhe është shpërndarë përmes platformës Teams. Realizuar nga arsimtarja Luljeta Shabani dhe pedagogu i shkollës Memed Mehmedi. Janë përgjigjur gjithsejt 36 respondent, rezultatet e përgjigjeve janë dhënë më poshtë me diagram shtyllor.  **Ju lutem që gjatë plotësimit të pyetësorit anonim të jeni sa më të sinqertë me qëllim që ky pyetësor të arrijë qëllimin e paraparë. Shënoni "√", në celulën para deklaratës që mendoni seështë e saktë.**

Organizimi dhe mësimdhënia	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë
1. A dëshiron fëmija juaj fëmija të shkojë në shollë?	84%	0%	0%	0%	16%
2. A thotë fëmija juaj se orët në shkollë janë interesante dhe e nxisin të mësojë?	95%	0%	0%	0%	5%
3. A mendon se shkolla është e mirë dhe ka kushte për punë të përshtatshme?	63%	0%	0%	0%	37%
4. A kërkojnë arsimtarët shumë dituri nga fëmijët?	79%	0%	0%	0%	21%
5. Arsimtarët vazhdimisht na tregojnë anët e mira të fëmijës tim dhe çfarë duhet të jetë më mirë.	100%	0%	0%	0%	0%
6. Arsimtarët rregullisht dhe në kohë më njoftojnë për përparimin e fëmijës tim.	100%	0%	0%	0%	0%
7. Të punësuarit në shkollë sillen mirë dhe unë ndjehem i mirë se ardhur atje.	89%	0%	0%	0%	11%
8. Arsimtari nxit fëmijën tim që ti shfrytëzojë të gjitha aftësitë e tij.	84%	0%	0%	0%	16%
9. I kushtohet kujdes shëndetit të nxënësve?	84%	3%	5%	3%	5%
10. A jeni të informuar me ndryshimet që ndodhin në shkollë?	68%	0%	0%	0%	32%
11. A merret parasysh mendimi juaj rreth vendimmarrjeve që bëhen në shkollë?	89%	0%	0%	0%	11%

12. Mbledhjet prindërore janë të organizuara rregullisht dhe gjatë tyre marrim informacione të dobishme?	77%	0%	0%	0%	23%
13. A jeni të informuar me kohë për vlerësimin e fëmijëve Tuaj?	89%	0%	0%	0%	11%
14. Në shkollë ka klimë pozitive për bashkëpunim arsimtar-prindër-nxënës dhe anasjelltas.	95%	0%	0%	0%	5%

Ju faleminderit për bashkëpunimin! Data e realizimit: 03 /06 /2021

Anketim ***Ekipi***

PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËSIT
ATMOSFERA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLË

Anketa është përpunuar në Forms dhe është shpërndarë përmes platformës Teams.
Realizuar nga arsimtarja Luljeta Shabani dhe pedagogu i shkollës Memed Mehmedi.
Janë përgjigjur gjithsejt 26 respondent, rezultatet e përgjigjeve janë dhënë më poshtë me diagram shtyllor.



Ju lutem që gjatë plotësimit të pyetësorit anonim të jeni sa më të sinqertë me qëllim që ky pyetësor të arrijë qëllimin e paraparë. Shënoni me "√", në qelulën para deklaratës së saktë.

Organizimi	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë
1. A marrin pjesë palët e interesuara (prindërit, nxënësit etj) në planifikimin e aktiviteteve shkollore dhe në marrjen e vendimeve			√		
2. Mendoni se jeni të stërngarukuar me risitë e vazhdueshme në arsim		√			
3. Iniciativat shkollore janë të lidhura drejtpërdrejt me qëllimet e shkollës		√			
4. Në shkollë ka sistem për përsosje të mësimdhënësve			√		
5. Drejtori është në gjendje të nxjerrë më të mirën		√			
6. Punët janë mirë të koordinuara		√			
7. Risitë pranohen pasi që bashkë kemi vendosur për to		√			
8. Kam besim te udhëheqësia shkollore		√			
9. I kushtohet kujdes shëndetit të të punësuarve	√				
10. Nga të punësuarit pritet të zbatohen vendimet e drejtorit para se të aftësohen për të njëjtat	√				
Hapësira					
1. Në krahasim me shkollat tjera disponojmë me pak hapësirë			√		
2. Hapësira ekzistuese shfrytëzohet me në mënyrë racionale	√				
3. Kam mundësi të shfrytëzojë çdo hapësirë shkollore për veprimtarinë mësimore	√				
4. Në shkollë kemi mjete didaktike-metodike të mjaftueshme			√		
5. Shkolla kujdeset të pajiset me teknologjitë inovative	√				
Motivimi					
1. Kam stimul dhe nuk ndjej kënaqësi gjatë punës			√		
2. Merret parasysh mendimi Juaj rreth vendimmarrjes		√			
3. Në shkollë ka klimë pozitive	√				

		4. Në shkollë shpërblehen ato që kanë qenë (janë) të suksesshëm	√				
		5. Mësimdhënësit vlerësohen sipas të arriturave profesionale dhe sipas angazhimit	√				
		6. Përkrahja e mësimdhënësve në shkollë është e madhe	√				
		Bashkëpunimi					
		1. Drejtori bashkëpunon me organet shkollore	√				
		2. Drejtori përkrah të punësuarit	√				
		3. Në shkollë është zhvilluar ndjenjë për punën në tim (ekip)	√				
		4. Drejtori ka përkrahje nga të punësuarit	√				
		5. Drejtori shfrytëzon burime nga komuna, organizatat e ndryshme	√				
		Data e realizimit: 03 /06 /2021 **Ju faleminderit për bashkëpunimin!**					

Rezultatet nga evalvimi shkollor të identifikuara si përparsi dhe mangësi

Anët e forta:

- ✓ ***Shkolla ka prestigj dhew imazh të mirë në bashkësin vendore dhe më gjërë.***
- ✓ ***Shkolla ka t[hartuar dhe implementon kodin për sjellje nga të punësuarit , nxënësit si respektohet rendi shtëpiak në shkollë.***
- ✓ ***Ekziston komunikim dhe bashkëpunim i hapur dhe transparent me të gjitha subjektet,***
- ✓ ***Në shkollë realizohen tema kushtuar multikulturës.***
- ✓ ***Trajtohen të gjithë në mënyrë të barabartë dhe me nxënës realizohen temave kushtuar të drejtave të fëmijëve.***

Anët e dobëta:

- ✓ ***Duhe të nritet bashkëpunimi më i madh me komunitetin afarist për ngritjen e cilësisë në shkollë.***
- ✓ ***Shkolla duhet të përcjell në form individuale përparimin e nxënësve për çdo vit shkollor.***

Analiza e rezultateve:

Imazhi i shkollës tërësisht kënaq standardet e funksionimit te institucionit edukativo arsimor, me çka pjesa më e madhe e të punësuarve kontribuojnë në afirmimin e shkollës, raportet në mes të arsimtarëve dhe nxënësve janë të mira dhe bazohen në respekt të ndërsjelltë. Kuadri arsimor gëzon respekt nga shumica dhe numri i madh i nxënësve dhe prindërve, gjë e cila sjell në identifikim të shkollës që respektohet me ndjenjë të kënaqësisë dhe sigurisë së punës efikase. E gjithë kjo, bazuar në realizimin e vizionit dhe misionit shkollor.

Në shkollë ka procedurë për kodin e sjelljes për nxënësit dhe të punësuarit. Kodi përmban dhe përgëzon respektin në mënyrë të barabartë: të moshës, gjinisë, nxënësve me dukuri të paraqitjeve emocionale dhe përfshirjen statusit social. Kodi i sjelljes është i miratuar nga të gjithë të punësuarit dhe është pjesë përbërëse e normave për punë dhe kodeksin etik të shkollës. Të gjithë kanë participuar në hartimin e tij dhe i njëjti respektohet nga të gjithë strukturat shkollore.

Në bazë të kushteve në të cilat realizohet procesi edukativo-arsimor konstatim i përgjithshëm është se në shkollën tonë ka klimë pozitive, respekt, ndjesi të kënaqësisë nga shumica për realizim të aktiviteteve të punës në shkollë si dhe arritjet e përbashkëta, trajtim të barabartë, bashkëpunim profesional në mes të të punësuarve etj.

Disciplina në përgjithësi kënaqë me çka vërehet dhe ekziston atmosferë pune gjithë kohës së mësimit dhe aktiviteteve jashtëmësimore. Nuk

janë hasur konflikte të rrënda. Shkolla resptekton dhe shqipton masat pedagogjike bazuar me ligjin për arsim fillor për nxënësit që pengojn gjatë realizimit të procesit mësimor dhe atyre që kanë qëndrim jo të drejtë ndaj vlerave shkollore. Në këtë drejtim ndihmon edhe bashkësia e nxënësve në nivel shkollor në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në shkollë, ka raste moskënaqësie por të njëjtat kanë përmirësime.

Participimi i nxënësit në zgjedhjen e problemeve dhe marjen e vendimeve respektohet vetëm në raste të realizimit të disa aktiviteteve, japin mendim, ide, meren parasysh si vërejtje apo lëvdata për punën dhe jetën në shkollë në biseda dhe takime në klasa. Nxënësve u jepet mundësia të shprehen me shkrim përmes kutisë postale shkollore e cila kontrollohet nga drejtori dhe e njëjta shqyrtohet, ku ka bazë të cilat kontribuojnë në ngritjen e cilësisë.

Në funksion aktiv është bashkësia e nxënësve apo parlamenti i nxënësve si organ i barabartë në shkollë – përmes mbledhjeve informohet për programin në punën e shkollës, aktivitetin, sukseset dhe të gjitha aktivitetet shkollore dhe të gjitha propozimet si anë të dobëta të shkollës apo kënaqësit si anë të forta merren parasysh dhe të njejtat shërbejnë për analiza të mëtutjeshme të përmirësimit të punës dhe suksesit shkollor.

Arritjeve të nxënësve shkolla i kushton rëndësi dhe shkolla disponon me dëshmi të mjaftueshme për promovimin personal të nxënësve për arritjet e tyre, mirëpo kuadri arsimor duhet më tepër të lëvdojnë nxënësit gjatë rezultateve. Nxitet kreativiteti i motivimi për pjesmarje në gara, shkollore, komunale dhe regjionale me aspirata më suksese më të larta individuale dhe shkollore.

Oganizimi planifikimi, interesimi dhe pjesëmarrja e nxënësve në gara viteve të fundit është më i madhë. Mirëpo ekzistojnë lëshime apo mospjesëmarrje nga disa lëndë të cilat shkolla duhet të ndërmer aktivitete dhe të bëjë përpjekie për përfshirjen e nxënësve në mënyrë të barabartë, dhe realizimin e detyrave të çdonjërit në bazë të rregullores së punës.

Në funksion legjislativ viteve të fundit obligimet dhe ndarja e detyrave të cdo arsimtari në lidhje me organizimin dhe realizimin e garave si formë e promovimit të vlerave dhe arritjeve në nivel të shkollës dukshëm janë përmirsuar, si rezultatet e ekipeve shkollore, informimit në kohë nga organet përgjegjëse si dhe shoqatat e akredituara për organizime të tilla.

Të drejtat e fëmijëve realizohen përmes orëve të bashkësisë së klasës si pjesë e shkathësive jetësore, orëve të arsimit qytetar, si dhe shkolla realizon planifikimin e programit " Të drejtat e mia" për nxënësit e tre cikleve të arsimit fillor nëntëvjecar. I-III, IV – VI dhe VII-IX, ku realizohen tema të përshtatshme për moshën e nxënësve e cila bazohet ne doracakun, mirëpo krahasuar për nevojat e njohjes, informative duhet të bëhet përpjekje për më shumë aktiviteteve në lidhje me të drejtat e fëmijëve, sindikatat, ligjin, konventat ndërkomtare, diskriminim etj.

Shkolla mirë e vlerson në bazë procedurave dhe aktiviteteve evaluese ku mundohet të zbatoj kulturë mësimore të barabartë për të gjithë nxënësit në aspektin gjinor, nuk ka raste deskriminimi por e tëra respektohet në të gjitha fushat arsimore dhe edukative.

Shkolla është e përfshirë në realizimin e projektit –PINA-USAID dhe mësimi realizohet vetëm në një gjuhë - gjuhën shqipe.

- Shkolla në bazë të aktiviteteve konstaton se elementet dhe prania e vlerave multikulturore edhe pse vërehet dhe haset shumë pak nuk paraqesin pengesë por përkundrazi ngjalli interesim nga shumica. Gjatë procedurave të informimit të arsimtarëve përmes komunikimeve të ndryshme (informime, vendime, rregullore, kërkesa etj) – përveç përmbatjeve programore nëpër lëndë të ndryshme, planin apo prezantimin e faktorëve tjerë – nuk ka raste të përvojave negative. Realizim të projektit për integrimin ndëretnik në masë të madhe janë realizuar aktivitete të përbashkëta dhe kanë shërbyer si shembull i mirë i vlerësimit të shkollës.

Shkolla mundohet që ti përfshijë më tepër prindërit në punën e shkollës si subjekte të barabartë, aktivitetet të ndryshme, në kuadër të rregullave ligjore për pjesmarje në aktivitetet e punës dhe vendimmarrje në këshillin prindëror dhe këshillin e shkollës. Bashkëpunimi i shkollës me prindër dëshmohet përmes takimeve individuale dhe mbledhjeve prindërore me kujdestarët e klasave, informime të rregullta për arritjet dhe suksesin e tyre. Ka raste të bashkpunimit në realizimi të akcioneve të ndryshme, aktiviteteve pune, manifestime etj. Mirëpo, duhet të ndërmerren aktivitete konkrete për participimin e prindërve në shkollë jo vetëm në pjesëmarrjen formale (këshillin e shkollës dhe këshillin prindëror).

Shkolla ka bashkëpunim të mirë me bashkësinë lokale, për organizimin dhe realizimin të aktiviteteve të ndryshme, manifestimeve, projekteve të cilat implementohen, informime të rregullta përmes komunikimeve elektronike, është në bashkëpunim të mirfilltë me udhëheqësinë e bashkësisë fetare (xhamisë) së fshatit dhe qytetarët për çdo lloj aktiviteti që shërben dhe është në dobi të të gjithëve si dhe klubin futbolistik të fshatit, të cilët ndihmojnë në aktivitet e ndryshme vullnetare.

Me komunitetin afarist shkolla ka bashkëpunim në realizimin e aktiviteteve në shkollë, infrastrukturë, projekte, investime të një numri afaristësh dhe zejtarësh të cilët mundohen të japin kontributin e tyre në përmirësimin e kushteve në shkollë, në aktivitetet e punës në forumin ne bashkësi, në EKO – programe, etj. Me sektorin qeveritar ka takime kur në bazë të projekteve duhet të ndihmohet në raste të ndryshme sidomos me Kryqin e kuq – ku ka donacione të ralla që u dedikohen nxënësve, sidomos atyre me vështirësi sociale-ekonomike.

PËRPARËSITË NË TË ARDHMEN*: Fushat me përparësi nën kornizat e këtij "plani për zhvillimin e shkollës. "*

- ✓ Përfshirje më të madhe të nxënësve në jetën dhe punën e shkollës
- ✓ Duhet të realizohen hulumtime, anketa me qëllim të identifikimit të arsyeve të mundshme për mungesat gjatë orëve mësimore si dhe procedurat këshilluese për mënjanimin e tyre.

Vetëevaulimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri " f. Pirok – Bogovinë

Fusha 6: Resurset

Treguesi i cilësisë:

6.1. Akomodimi dhe kapacitetet hapësinore.
6.2. Mjetet dhe materialet mësimore
6.3. Sigurimi i kuadrit të nevojshëm mësimor.
6.4. Ndjekja e nevojshme zhvillimore të kuadrit mësimor
6.5. Puna financiare në shkollë.

Vetëevaulimi i shkollës: SH. F.K. „ Sami Frashëri “ – Pirok – Bogovinë

Fusha 6: Resurset

Fusha 6: Resurset ***Trequesi i cilësis: 6.1 Akomodimi dhe kapacitetet hapësinore***	
Dokumentet e shqyrtuara (Të dhënat burimore)	**Informacioni i mbledhur**
- *Statuti i shkollës* - *Programi vjetor për punën e shkollës.* - *Plani zhvillimor i shkollës,* - *Orari i mësimit* - *Raporti i gjysmëvjetorit dhe i fundvitit* - *Proçesverbalet nga Inspektorati arsimor dhe ai sanitar,* - *Proçesverbalet nga puna e grupeve (aktiveve)profesionale*	***Tema:6.1.1. Kushtet hapësinore*** Shkolla fillore „ Sami Frashëri” Pirok – komuna e Bogovinës procesin edukatiovo-arsimor e realizon në një objekte shkollorë dhe plotësohen kushtet për mbatjen e mësimit si dhe madhësitë e klasave përshtaten me numrin e nxënësve në përgjithësi. Për të gjitha objektet më poshtë japim të dhënat më të detajuara për vlerësimin e tyre teknik. • Numri amë i shkollës-**4035020 themelimi:23.12.1965 / vendimi nr. O6 - 11777/1** • Regjistrimi te rregjistri kryesor: – (10.11.2014) pronësi komunale – Objekti i vjetër 1962 – Objekti i ri 1965 – Objekti në f. Pirok 1965 • Sipërfaqja e oborrit shkollor 800 m/2 • Sipërfaqja e objektit: 1206 – shfrytëzimit të procesit mësimor • Sipërfaqja e përgjithsme: 24595 m^2. • Sipërfaqja e përgjithshme e cila shfritëyohet si objekt me qëllim pedagogjik 820 m/2., zyra e e arsimtarëve, drejtorit, sekretarit, pedagogut, biblioteka shkollore. • Sipërfaqja e përgjithshme për mir[mbajtje të objektit 2071 m/2 Në shkollë janë të përfshirë 387 nxënës ku meshkuj 188 dhe femra 199 – të sistemuar në 25

- *Statistika shkollore* - *Plani financiar* - *Proçesverbalet nga Inspektorati arsimor dhe ai sanitar,* - *Proçesverbalet nga puna e grupeve (aktiveve)profesionale* - *Anketa (pyetësori) për nxënës*	paralele – ku konstatohet se hapësirat në tërësi përmbushin nevojat dhe kushtet e duhura për mësim. Shkolla nuk i plotëson nevojat e nxënësve të klasave të I- para qe të punojnë me ndryme bazuar në moshën e nxënësve 6 vjeçare, me cka duhet të ndërtohen edhe 1 klasë tjera për përmbushjen e kritereve dhe standarteve arsimore. Shkolla plotëson kriteret dhe kërkesat e kohës së re, inventarizimin të nevojshëm hapësirat dhe zyrat e rregulluara dhe adaptuara për punë, dritare me PVC profil. Shkolla posedon me kabinet të shkencave natyrore i pajisur me kompjuter,printer,projektor. ***<u>Tema: 6.1.2. Shfrytëzimi i kapaciteteve hapësinore</u>*** Shkolla ka plan të qartë për shfrytëzimin e kapaciteteve të mundësive të mundshme hapsinore të procesit mësimor. Me të cilat plotësohen nevojat e nxënësve. Shkolla për shkak të pandemisë ka shfrytëzuar hapsirat tjera si oborri i shkollës ,nxënësi e klasave I deri III me pjesmarje fizike, rregullimin e ndriçmit më të madhë të objektit, koridoreve,mësojtorëve, në oborin shkollor,dera e hyrjes duke marur parasysh planin e zhvillimit të shkollës duhet të rregullohet panoja e shkollës, gazeta e murit, hapësir (zyrë) për bashkëpunim me prind, kabinetet për realizim të mësimit bashkëkohor.etj. Shkolla nuk posedon me sallë sportive që e vështirëson realizimin e lëndës së arsimit fizik dhe shëndetësot dhe aktivitetet tjera sportive.

- *Dokumentet e shqyrtuara* - *(Të dhënat burimore)*	***Trequesi i cilësis: 6.2 Mjetet dhe materiale mësimore***
- *Mbikqyrje e drejtëpërdrejtë në dokumentacionin e shkollës,* - *Evidenca e inventarizimit* - *Raporti i evaulimit integral* - *Plani për furnizim publik* - *Dokument nga përfaqësues të MASH.* - *Lista për evidencë* - *Evaluimi personal i nxënësve dhe plani zhvillimor i shkollës,* *Intervista dhe anketat me nxënësit dhe mësimdhënësit,*	***Tema: 6.2.1. Pajisja me literatura profesionale dhe mjete ndihmëse mësimore*** Shkolla disponon me një numër të konsiderueshëm të mjeteve mësimore, kompjutera për lehtësimin e procesit mësimor, me çka ka numër të konsiderueshëm apo të mjaftueshëm të literaturës profesionale – ka ekzemplarë me çka i plotëson kushtet optimale për ngritje profesionale dhe janë me rjedhat mësimore cila plotësohet me kërkim të materialeve përmes internetit ,llaptopat për nxënës, laptopat e mësimdhënësve – projekt i ministrisë së arsimit , shkolla disponon me 2 aparate për fotokopje për nevojat e nxënësve, arsimtarëve dhe shkollës , shkolla nuk është pajisur mjaftueshëm me mjete mësimore për realizimin e përmbatjeve programore. Ka procedurë për furnizim me kompjutera që të plotësohen nevojat e nxënësve, ka plan për pajisje e shkollës me mjete ndihmëse. ***Tema: 6.2.2.Biblioteka shkollore*** Biblioteka shkollore ka gjithsej 8534 ekzemplarë – ku pjesa më e madhe e titujve janë lektyra shkollore, ndërsa literatura tjetër ka karakter të përmbatjeve shoqërore, shkencore, historike – ku me fillimin e vitit shkollor bilioteka është furnizuar me titujve të shkrimtarëve botëror ku pjesa më e madhe janë Nobelist. Bibliotekisti mban evidencë për mënyrën e funksionimit dhe bashkëpunimit me nxënës, arsimtarë ka raste edhe të mosheve të ndryshme, mirëpo shkolla duhet të bëjë përpjekje dhe

